



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK



Nr. 613/ 13

Datë 03.06.2024

V E N D I M

Nr. 598/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, me fond limit 35,977,266 pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Skualifikimin e operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

Ankimues: BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK me Nipt L222180133G dhe Adresë: Rruga “Dritan Hoxha”.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë

Subjekt i interesuar: Operatori ekonomik “ALTEC” SHPK me NIPT: K57923807W, me Adresë: Njësia Administrative "Fratar", Fshati "Ninesh", Rruga "Qender", Godina Nr.15, BALLSH "Mallakaster", Ballsh, Fier.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

1.2. Operatori ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomikë ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.4. Operatori ekonomikë ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.12.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, me fond limit 35,977,266 pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 15-01-2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 01.03.2024, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | | |
|---|--------------------|--------------|
| 1. “ALTEC” SHPK | 27.162.140.00 lekë | Kualifikuar |
| 2. BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK | 33.332.200 lekë | Skualifikuar |
| 3. “SULOLARRI-KLIMA” SHPK | 35079400 lekë | Kualifikuar |

II.4. Në datën 04.03.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 11.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 613 prot. e operatorit ekonomik BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë”, me fond limit 35,977,266 pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Ankesa lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK

II.5.1. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 613/2 prot prot, datë 11.03.2024 , lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, dhe pretendime mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK.

II.5.2. Në formë shkresore me nr. 14 prot., më datë 18.03.2024, protokolluar me tonën me nr. 613/3 prot., datë18.03.2024 , operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumenteve, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

II.6 Në datën 19.03.2024, Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 264/5 prot., protokolluar në KPP me nr. 613/4, datë 25.03.2024, ka dërguar informacionin dhe vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Me vendimin nr.264/3 prot., datë 18.03.2024 KSHA ka vendosur refuzimin e ankesës të operatorit ekonomikë ankimues.

II.7. Në datën 28.03.2024, në formë shkresore, Komisioni Prokurimit Publik, i dërgon shkresën me nr. 613/5 prot., Autoritetit Kontraktor Agjencisë Shtetërore Të Prokurimeve Të Përqendruara me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE ‘Ecs Eco Climate Solution Sh.A dhe Edmeli’” SHPK.

II.8 Në datën 02.04.2024, Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. prot 364/7, protokolluar në KPP me nr.613/6 , datë 05.04.2024, ka dërguar informacionin dhe vendimin e KSHA, bashkëlidhur dokumentacionin e operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK pranë autoritetit kontraktor.

II.9 Më datë 09.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresën Nr. 613/7 prot., me lëndë “Vënie në dijeni” Autoritetit Kontraktor dhe Operatorëve Ekonomikë me përmbajtje “[...]referuar Komisioni Prokurimit Publik ju bën të ditur të gjitha palëve të mësipërme, se për një shqyrtim sa më të drejtë, transparent dhe objektiv të ankesës ka kërkuar informacion shtesë, dhe verifikim nga palë të treta (institucione shtetërore vëndase/huaja, kombëtare/ndërkombëtare), dhe në referim të dispozitave të sipërcituara afatet për shqyrtimin e ankesave në lidhje me procedurën sipërcituar objekt ankimi, do të ndërpriten deri në mbërritjen e informacionit të kërkuar.[...]”.

II.10 Më datë 09.04.2024, Komisioni i Prokurimit Publik dërgon shkresën Nr. 613/8 prot., me lëndë “Kërkesë për informacion” FSHU, me përmbajtje “Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:

1. Kontratat e energjisë elektrike së bashku me adresat në të cilat është titullar ose përdorues subjekti tregtar “ALTEC” SHPK, të cilat janë aktive në datën 15.01.2024.
2. A rezulton të jetë subjekti tregtar “ALTEC” SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresat e Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar Historik bashkalidhur. ?
3. Nëse është përdorues në adresat e mësipërme (në ekstraktin e rregjistrimit tregtar historik), a ka patur detyrimin që subjekti tregtar “ALTEC ” SHPK ta deklarojë këtë fakt pranë furnizuesit me energji elektrike “Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU” ?[...]

III.11 Më datë 22.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik dërgon shkresën Nr. 613/9 prot., me lëndë “Rikërkesë për informacion” FSHU me përmbajtje “Komisioni i Prokurimit Publik ka dërguar shkresën me lëndë “Kërkesë për informacion” me nr. 613/8, datë 09.04.2024, me përmbajtje :[...] Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:

1. Kontratat e energjisë elektrike së bashku me adresat në të cilat është titullar ose përdorues subjekti tregtar “ALTEC” SHPK, të cilat janë aktive në datën 15.01.2024.
2. A rezulton të jetë subjekti tregtar “ALTEC” SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresat e Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar Historik bashkalidhur. ?

3. Nëse është përdorues në adresat e mësipërme (në ekstraktin e rregjistrimit tregtar historik), a ka patur detyrimin që subjekti tregtar "ALTEC" SHPK ta deklarojë këtë fakt pranë furnizuesit me energji elektrike "Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU" ?[...].

Pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk kemi asnjë përgjigje nga ana juaj mbi shkresën e derguar nga ana jonë. Ju lutemi, sa më sipër për një shqyrtim sa më të drejtë të çështjes të dërgoni pranë Komisionit Prokurimit Publik informacionin e kërkuar ?[...]

III.12 Në datën 28.05.2024, Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A, ka kthyer përgjigje me shkresën me Nr.2357/2, protokolluar me tonën Nr. 613/10 prot., datë 28.05.2024, me lëndë "Kthim - Përgjigje", ku citohet, se " Në përgjigje të shkresës Nr. 613/9 Prot, date 22.05.2024, të regjistruar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A, me Nr.2357/1 Prot, date 23.05.2024 me ane të se cilës kerkoni paraqitjen e informacionit, sqarojme si vijon: 1) Subjekti " ALTEC" SHPK, referuar sistemit tone të faturimit ka

1 (nje) kontrate të furnizimit me energji elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal sha. pjese e Grupit OSHEE Nr. XXXXXXXXXXXX, ne instancen Tirane.

2) Subjekti " ALTEC" SHPK, rezulton si përdorues i 1 (një) kontrate ne instancen Fier, me NrXXXXXXXXXXXX dhe me titullar z.T.H.A.

Referuar sistemit tone të faturimit, ju veme ne dijeni se me adrese e kemi të pamundur të identifikojme kontraten dhe abonentin. Sistemi mundëson gjurmimin e kontrates vetem me numër matesi, numer kontrate dhe me gjeneralitete të abonentit (emer, atesi, mbiemer)

3) Bashkëlidhur gjeni detajet e kontrates, si dhe gjendjen e debise për kontratat e sipërpermendura. Me konsiderate,

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "BOE "Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK", mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: "Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 dhe 4, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratën se merr përsipër kryerjen e punimeve dhe shërbimeve mirembajtëse në çdo ore gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nuk ka paraqitur dhe deklaratën për Agregatat/Pajisjet/Pjesët e këmbimit të cilat duhet të ofrohen te reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi..", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8, tek "Kapaciteti ekonomik dhe financiar:", autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.3 dhe 2.3.4 :

3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.2. Në shtojcën 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar</i>

• *Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektivin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____



kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____



Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

<p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshtëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimiti profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> <u>Profili i punonjësve</u> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetëdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.3 Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK” ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1-- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Ecs Eco Climate Solution SHA” dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të “Edemeli” SHPK.

Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “A”: “DEKLARATË “Në përputhje me Specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”, BOE Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK deklaron:

Edemeli SHPK

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari Sami Jaupi në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik Edmeli sh.p.k deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	Edmeli shpk
Numri NIPT/et:	J91524018T
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Rr. Rrapo Hekali, Tirane Kodi Postar 1001
Përfaqësuesi (emri):	Sami Jaupi
Telefoni:	067 20 42 125
E-mail:	Edmeli1999@gmail.com

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit


A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 1 <u>Profili i punonjësve:</u>  <u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo []

Ecs Eco Climate Solution SHA

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatorit ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari Edmond Jaupi në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik Ecs Eco Climate Solution sh.a deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	Ecs Eco Climate Solution sh.a
Numri NIPT/et:	L22218013G
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Rr. Dritan Hoxha, Tirane Kodi Postar 1001
Përfaqësuesi (emri):	Edmond Jaupi
Telefoni:	069 60 88 191
E-mail:	info@ecs.al

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: • Informacione për nënkontraktorin
--

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X] Jo []



Adresa: Rruga "Dritan Hoxha", Tirana Ring Center, Kati 0, Tirana Albania.
Email: info@ecs.al; projekte@ecs.al; service@ecs.al.Tel.:+355 (0) 4 242 3000 / +355 (0) 69 60 88 191

7

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuara, nëse fitoi, ose nëse më kërkohen	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 6 Profili i punonjësve:

III.1.4. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.5. Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor,*

social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.

III.1.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin

ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, 3. *Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.* BOE ka dorëzuar formularin e tij përmbledhës të vetëdeklarimit mbi këtë kërkesë, duke cituar në formularin përmbledhës se “Pjesa III Kriteret e Perzgjedhjes/ A- DEKLARATE Ne perputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit Deklarata Pergjigje Ne cilësine e operatorit ekonomik ne deklarojme se i plotesojne se gjitha specifikimet teknike dhe termat e references, sig udhezohet ne dokumentet e tenderit dhe kete e provojme permes certifikatave dhe dokumenteve se paraqitura me kete deklarate nëse kerkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor). dhe marrim persiper realizoime objektin ne perputhje me Listen e sherbimeve dhe grafikun e ekzekutimit te percaktuar” X (PO), dokument të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevoje apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Komisioni konstaton, BOE me dorëzimin e Formularit

të tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ka plotësuar të gjitha të dhënat e mundshme që parashikon formulari përmbledhës, konkretisht ka deklaruar, se merr përsipër realizimin e objektit në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.

III.1.11. Konkretisht, referuar kriterit në pikën 2.3.3, ku Operatori ekonomik duhet të deklarojë se merr përsipër kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konstatohet se BOE ka dorëzuar, në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Formularin e tij Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” të tyre, shkronja A “Në përputhje me Specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”, kanë deklaruar se marrin përsipër kryerjen e këtij shërbimi. Ndaj KPP, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor lidhur me këtë pikë është përmbushur nga BOE lidhur me deklarinimin se do kryejë këtë shërbim. Kërkesa e përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor është kërkesë e publikuar që nuk i shërben qëllimit të tij në njohjen e kapaciteteve, theksojmë se kriteret e kualifikimit, vendosen për njohjen e veprimtarive profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare, aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se arsyeja e skualifikimit lidhet me faktin, se operatori ekonomik ankimes nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 dhe 4, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratën se merr përsipër kryerjen e punimeve dhe shërbimeve mirëmbajtëse në çdo orë gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. KPP gjykon, se BOE ka arritur të provojë këtë kërkesë me anë të formularit të Vetëdeklarimit. Këtë verifikim autoriteti kontraktor e ka mbështetur mbi një kriter i cili është vendosur në tejkallim të parashikimeve të ligjit të prokurimit publik, pasi ligji dhe aktet nënligjore qartësisht normojnë mënyrën se si do të përmbushet ky kriter, përmes formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit miratuar me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik.

KPP vlerëson, se ligjvënësi ka parashikuar dy momente të përcaktimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Momenti i parë lidhet me kriteret e kualifikimit, si përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, gjendjen ekonomike dhe financiare, aftësinë teknike dhe profesionale, të cilat ligjvënësi i ka lënë në diskrecion të autoritetit kontraktor përcaktimit të tyre, diskrecion, i cili edhe në kuptim të nenit 11 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nuk mund të tejkalojë kufijtë e vendosur nga ligji dhe konkretisht, atë të vendosur në nenin 77 të ligjit për prokurimin publik, pra të jenë në proporcion me natyrën, volumin dhe përmasat e kontratës, si edhe të mos jenë diskriminuese.

Së dyti, është grupi i kritereve të kualifikimit, të cilat janë të shprehura qartësisht në ligj ose në akt nënligjor dhe që janë detyruese për të gjithë autoritetet kontraktore.

Pra, elementi i domosdoshëm për të përmbushur fazën e parë të vetëdeklarimit në drejtim të marrjes përsipër të kryerjes së kësaj procedure, është vetëm plotësimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Ndërkohë në rastin konkret, autoriteti kontraktor e ka skualifikuar mbi një kriter i cili nuk parashikohet nga ligji i prokurimit publik, duke dublikuar formatin dhe përmbajtjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit në një kërkesë të veçantë të përcaktuar në kriteret e veçanta të kualifikimit.

Komisioni i Prokurimit Publik shfaqet në cilësinë e një organi quasi gjyqësor, i krijuar në përputhje me Direktivën 89/665, datë 21 dhjetor 1989, krijuar me ligj, për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi. Në zbatim të nenit 24 pika 3 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”* në të cilin përcaktohet se: *“Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit”*, Komisioni thekson, se qëndrueshmëria në vendimmarrje tashmë e konsoliduar prej tij, është një prej elementeve thelbësore të shqyrtimit të ankesave, për arsye se ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mbi të gjitha të sigurisë juridike, të cilat KPP gjatë kryerjes së detyrave të saj zbaton me profesionalizëm, integritet dhe korrektësi, kuadrin ligjor të prokurimeve publike.

Për sa më sipër, pretendimi i BOE *“Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK, qëndron.*

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK , mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 dhe 4, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratën se merr përsipër kryerjen e punimeve dhe shërbimeve mirembajtëse në çdo ore gjatë gjithë ditëve kalendarike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, nuk ka paraqitur dhe deklaratën për Agregatet/Pajisjet/Pjesët e këmbimit të cilat duhet të ofrohen te reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi..”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8, tek *“Kapaciteti ekonomik dhe financiar:”*, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.4: *4.Operatori ekonomik duhet të deklarojë Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi.*

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

III.2.2 Në shtojcën 6 dhe 7, autoriteti kontraktor ka përcaktuar :

Shtojca 6

1.1.1.1.1.1.1.1 (Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

1.1.1.1.1.1.1.2 (Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të minikonkursit)

1.1.1.1.1.1.1.3

1.1.1.1.1.1.1.4 FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

1.1.2 Shërbimi që kërkohet:

1.1.3

Afatet e ekzekutimit:

1	Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë	24 muaj
---	---	---------

Vendi i kryerjes së shërbimit: Godina e Kryeministrisë

Shtojca 7

1.1.3.1.1.1.1.1 (Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

1.1.3.1.1.1.1.2 FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

2 Menaxhimi i funksionimit dhe mirëmbajtjes të sistemit VRV në ndërtesën e Kryeministrisë

2.1 Termat teknike për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit tip VRV në ndërtesën e KM katet -1, 0, +1, +2.

2.1.1 Përshkrimi i kufijve të mirëmbajtjes

Në fund të vitit 2017 është përfunduar me sistem kondicionimi kati -1 ku është vendosur arkiva e Kryeministrisë dhe muzeu dhe në vitin 2019 është përfunduar dhe kolauduar sistemi i kondicionimit tip VRV në ndërtesën e Kryeministrisë, katet 0, +1, +2 me markën DAIKIN dhe zyrat qendrore të Kryeministrit me markën Toshiba.

Ndërtesa është klimatizuar me ajër të kondicionuar dhe përfshin tre kate të pjesës kryesore të ndërtesës të Kryeministrisë (KM) nga ana e bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe gjithashtu katin e minus një që është bodrumi, zyrat qendrore të Kryeministrit sipas projektit të realizuar “as build” e cila është në dokumentacionin e kolaudimit. Projekti është realizuar kufijtë e ndërtesës të cilat janë:

- a. Kati zero, është i klimatizuar në të gjithë sipërfaqen e godinës duke përfshirë zyrat, korridoret, hollet.
- b. Kati i parë (+1) përfshin me klimatizim të gjithë pjesën e godinës si zyrat qendrore të Kryeministrit, që ndodhen në anën perëndimore të godinës, hollet, korridoret, sallat e mbledhjeve dhe zyrat.
- c. Kati i dytë (+2) është i klimatizuar në të gjithë sipërfaqen e tij duke përfshirë hollet, korridoret, zyrat dhe sallat e mbledhjeve.
- d. Kati minus një (bodrumi) është i klimatizuar në pjesën perëndimore nga ana e bulevardit “Dëshmorët e Kombit”.

2.1.2 Kufijtë e sistemit AC

Mirëmbajtja e sistemit teknik të ajrit të kondicionuar, përfshin, përveçse përmirësimin e performancës energjetike të projektuar dhe të zbatuar, edhe vendosjen e kriterëve dhe protokolleve teknike të cilat sigurojnë eficiencë të lartë dhe siguri shëndetësore që klasifikohet si element thelbësor i lidhur ngushtë me mirëmbajtjen e ndërtesës historike.

Sistemi i Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar në Kryeministri, është një *sistem qendror i copëzuar* i përbërë nga njësitë e brendshme dhe të jashtme si edhe rikuperatorët e nxehtësisë. Njësitë e brendshme dhe të jashtme lidhen përmes tubacioneve të gazit refrixherant dhe ajri shpërndahet me anë të njërive të brendshme të cilat janë tip kasetë ose kanalore. Njësitë e brendshme kanalore dhe rikuperatorët e përpunojnë ajrin e freskët ose riqarkullues përmes kanaleve të ajrit të cilat quhen ndryshe, kanale ventilimi.

Të gjitha pajisjet e ansambluara kanë fuqinë e instaluar termike 454.6kË – ngrohje dhe 349.6kË – ftohje. Makinat termike që mbajnë këtë ngarkesë janë objekt i mirëmbajtjes sipas kateve, përfshirë zyrën kryesore të Kryeministrit të përshkruar më lart:

KATI 0 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente) – në total 6 sisteme me 12 njësi të jashtme dhe 79 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 33,5-37,5 kË 6 copë dhe 45,0-50,0 kË 6 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kË 75 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 4 copë.

KATI +1 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente) – në total 9 sisteme me 14 njësi të jashtme dhe 87 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 28.0-33,5-37,5 kË 5 copë, 45,0-50,0 kË 8 copë dhe 56.0-63.0 1 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kË 77 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 7.1-8.0 kË 5 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 5 copë.

KATI +2 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente) – në total 7 sisteme me 13 njësi të jashtme dhe 91 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 28.0-33,5-37,5 kË 5 copë, 45,0-50,0 kË 8 copë dhe 56.0-63.0 1 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kË 71 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 7.1-8.0 kË 8 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 2 copë.

Kryeministria ndërtesa qendrore

KATI 0, +1, +2 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin, Toshiba (ose ekuivalente) – në total 3 sisteme me 7 njësi të jashtme dhe 9 njësi të brendshme kanalore dhe 15 rikuperatorë energjie nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 20.0-23,5, 13.4-15.5, kË 7 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 5 copë.
- Njësi të brendshme incasso 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 4 copë.
- Rikuperatorë energjie ajruesa 15 njësi.

KATI -1 (arkiva) – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente)

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 45.0-50.0kË 1 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0 dhe 5.6-6.3kË 13 copë.

2.2 Qëllimi i mirëmbajtjes

Qëllimi i mirëmbajtjes është që sistemi i kondicionimit të jetë totalisht në punë gjatë 24 orëve në 7 ditë të javës për 350 ditë të vitit (përfshijë këtu një periudhë pushimi 5 ditore). Gjithashtu, sistemi i kondicionimit me qëllim që të sigurojë rregullimin e temperaturës dhe të sasive të projektuara dhe të realizuara të ajrit të freskët në mjediset e brendshme ashtu siç është projektuar, duhet të mirëmbahet duke pastruar filtrat në mënyrë të vazhdueshme dhe duke kontrolluar mirëfunksionimin.

Ajri i freskët përmes rikuperatorëve të energjisë sigurohet të futë minimalisht rreth 25% ajër të jashtëm, i cili përpunohet në të gjithë ndërtesën së bashku me ajrin riqarkullues. Ky sistem kërkon domosdoshmërisht kontroll absolut të filtrave të ajrit në njësinë e këmbimit të nxehtësisë dhe frekuencë më të lartë të pastrimit/ndërrimit të tyre.

Kjo situatë kërkon që njësitë me rikuperim nxehtësie, përveçse të sigurojnë që të ruajnë 50-60% temperaturën (nxehtësinë) e ajrit të brendshëm që del nga rikuperatori, duhet të bëjnë ndryshimin (ose pastrimin) e filtrave në kontakt me ajrin e jashtëm, të paktën një herë në javë për 52 javë të vitit. Kështu, ajri që do të ri-qarkullojë në mjediset e ndërtesës nëpërmjet kanaleve të ajrit është e domosdoshme të përshkojë sistemin e rikuperimit të Energjisë për të ndryshuar parametrat termike, siç janë temperatura dhe lagështia e ajrit të brendshëm të përzier me ajrin e jashtëm.

2.3 Koha e punës e domosdoshme për Mirëmbajtjen e sistemit të ansambluar të kondicionimit.

2.3.1 Kërkesa minimale në ndërtesën që kondicionohet

Kryeministria (kati “-1”, “0”, “+1” “+2”), është një ndërtesë e konstruktuar në vitet 1940-1941, e tipit italian dhe me inerci të lartë termike të ruajtjes të nxehtësisë në strukturën e saj. Si karakteristikë termike kjo ndërtesë ofron muraturë të rëndë dhe një raport shumë komod mes dritareve dhe mureve rrethuese. Kjo gjë bën të mundur ruajtjen e nxehtësisë së të ngrohtit dhe të ftohtit në parametra maksimale (krahasuar me ndërtesat e “lehta” në Tiranë).

Koeficienti i masivitetit në këtë ndërtesë është 0.75, që do të thotë raporti mes volumit të okupuar (kondicionuar) dhe volumit të matur nga jashtë ndërtesës së bashku me strukturën është mjaft i lartë. Pra, 25% e volumit të ndërtesës është muraturë, e cila me ngrohjen dhe/ose freskimin e saj “ngarkohet” me nxehtësi e cila “i kthehet” ndërtesës pas një farë kohe dhe mbetet një burim nxehtësie që reflekton gjatë kohës kur impianti është në qetësi dhe/ose në rastet kur nuk funksionon për ndonjë arsye. Kjo situatë është një faktor arkitektonik dhe konstruktiv mjaft pozitiv dhe e ndihmon punën e sistemit.

Me këtë rast mund të themi se koha minimale për të “lejuar” ndërtesën në tërësi pa trajtim me kondicionim është rreth 3-6 orë, kohë gjatë së cilës duhet të reagojë skuadra e mirëmbajtjes për të riparuar një defekt të mundshëm në njësitë e brendshme dhe të jashtme.

Kështu nga analiza e bërë rezultoi se:

- Koha më e shkurtër në dispozicion të riparimit të njësive të brendshme është 3 orë.
- Koha më e shkurtër në dispozicion të riparimit të njësive të jashtme është 6 orë.

Si konkluzion:

- Njësia e brendshme e tipit kasetë mund të riparohet për:

- 30 minuta për ndryshim filtri ajri,
- 1 orë për ndryshim/zhbllokim të pompës së kondensatit,
- 2 orë për ndryshim të paketës elektronike të marrjes së komandave ëireless,
- 3 orë për t'u zëvendësuar me një të re.
- Njësia e brendshme e tipit kanalor
 - 30 minuta për ndryshim filtri ajri,
 - 1.5 orë për ndryshim të pompës së kondensatit,
 - 2.5 orë për ndryshim të paketës elektronike të marrjes së komandave ëireless,
 - 4 orë për t'u zëvendësuar me një të re (paketa elektronike),
 - 0,5 deri 1 orë për të vendosur mbulesën me karton-gips së bashku me shpatullimin, dhe 0,5 orë për lyerjen e gipsit pas tharjes së bojës.
- Rikuperatori i ajrit
 - 30 minuta ndryshimi i filtrit të brendshëm dhe të jashtëm,
 - 2 orë ndryshimi i pompës së kondensatit,
 - 2.5 orë ndryshimi i komanduesit elektronik,
 - 4 orë për të ndryshuar këmbyesin ajër-ajër,
 - 4 orë për të ndryshuar mbulesën prej gipsi,
 - 2 orë vendosja dhe lyerja e karton-gipsit.
- Njësitë e jashtme
 - 40 minuta Pastrimi i këmbyesit të nxehtësisë ajër/refrixherant,
 - 20 minuta pastrimi i tavës së drenazhit të kondensatit,
 - 30 minuta këqyrja e lidhjeve elektrike dhe dëmeve,
 - 4 ditë për të ndryshuar kompresorin,
 - 2 orë vendosja në punë.

2.4 Rëndësia e mirëmbajtjes. Parimet e sigurisë të shëndetit.

Sistemi i Kondicionimit është i lidhur ngushtë me ngarkesat termike për ngrohje/ftohjen e Kryeministrisë, ngarkesë e cila jepet për të dy periudhat (Ngrrohje/Ftohje) përmes impiantit të Sistemit të Ngrrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar për punë të vazhduar 350 ditë dhe 24/7 orë. Impianti domosdoshmërisht qëndron në gjendje pune përgjatë vitit dhe duhet të jetë në gatishmëri për 8400 orë dhe për arsye shërbimi kërkohen që ai të ndalohet të paktën 65 orë. Kështu rreth 360 nga 365 ditë të vitit (totali vjetor është 8760 orë/vit) kërkohet shërbim i thelluar 15 ditë të vitit për pjesë të veçanta të sistemit.

Nisur nga siguria për shëndetin e zyrtarëve të shërbimit civil dhe funksionit të rëndësisë së veçantë që përfaqëson ndërtesa e Kryeministrisë parimet e mirëmbajtjes janë:

- Parimi i shëndetit përmes komfortit dhe ndryshimeve të ajrit të brendshëm me ajër të jashtëm (të freskët dhe sasinë natyrale të O₂).
- Parimi i sigurisë në punë duke larguar me ajrin të gjitha elementët e dëmshëm për shëndetin dhe aromat nga pajisjet elektronike, printerat, fotokopjet, mobiljet, mbetjet, avullimet, frymëmarrjet njerëzore, ushqimet, etj.

- Parimi i komfortit termik të temperaturës së ajrit sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë.
- Parimi i vazhdueshmërisë së punës së impiantit për 350 ditë dhe 24/7 orë.
- Parimi i reagimit të skuadrës së mirëmbajtjes në kohën e përcaktuar në paragrafin më lart.

2.4.1 Kufijtë e brendshëm të komfortit pas mirëmbajtjes

<i>Temperaturat</i>	<i>Dimër</i>	<i>Verë</i>
Në Zyra	20 ± 1°C	25 ± 1°C
Në Salla Pritje	21 ± 1°C	23 ± 1°C
Në Salla Mbledhje	23 ± 1°C	23 ± 1°C
Në Korridore	20 ± 1°C	25 ± 1°C
Lagështia relative	30-40%	60%

<i>Niveli i zhurmave</i>	<i>kriteri i zhurmave</i>
I krijuar nga pajisjet e ndërtesës	NC 45 (Noise Criteria)
Në Zyra	NC 35
Në Salla Pritje	NC 35
Në Salla Mbledhje	NC 35

<i>Sasitë e ajrit ventilues</i>	<i>parametra të sistemit</i>
Zyra	5 l/s për person ajër i freskët
Tualete	12 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)
Salla Mbledhje	2 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)
Korridore	2 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)
Qarkullimi i brendshëm	2.0 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)

2.5 SISTEMI KANALOR

2.5.1 Cilësia e kërkuar për materialet e vendosura për mirëmbajtjen.

Punimet që do të kontrahohen për mirëmbajtjen duhet të përfshijnë, furnizimin me pjesë ndërrimi, makineritë ngritëse, testimin, balancimin si dhe vendosjen për punë të sistemit të ajrit të kondicionuar si një i tërë sipas markës DAIKIN/Toshiba ose ekuivalente. Është detyrë e kontraktorit të mirëmbajtjes, zgjedhja e pajisjeve mbështetëse të tilla që mundësojnë realizimin e procesit të mirëmbajtjes dhe përzgjedhjes së “skuadrës së mirëmbajtjes” të aftë për të kuptuar dhe realizuar proceset e mirëmbajtjes të parashikuara në këtë raport.

Në specifikimet teknike të makinave të sistemit me ajër të Kondicionuar, instruksionet e mirëmbajtjes është e domosdoshme të respektohen duke ndjekur protokollin e parashikuar në to. Inxhinieri i zbatimit të mirëmbajtjes duhet të vendosë për pjesë ndërrimi dhe materiale të certifikuar dhe origjinale të prodhuara nga prodhuesi i pajisjeve.

Gjithashtu materialet e kanaleve të ajrit, tubacioneve, filtrave dhe pjesët e ndërrimit të njësive të jashtme dhe të brendshme duhet të jenë të njëjta me ato të vendosura aktualisht në sistemin e kondicionimit.

2.5.1.1 Sistemi i kanaleve të ajrit

Në rast të dëmtimit, por edhe nëse nuk ndryshohen nga mirëmbajtja, të gjithë kanalet e ajrit duhet të zëvendësohen/riparohen në përputhje me vizatimet “as build” të zhvilluar nga kontraktori zhvillues i sistemit të kanaleve të ajrit. Kontraktuesi i mirëmbajtjes nuk ka të drejtë të ndryshojë projektin pa lejen e autoritetit kontraktues dhe të projektuesit. Çdo ndërhyrje në kanalet e ajrit duhet të bëhet nëpërmjet dritareve/portave të lejuara në tavanin me kartongips që janë përshkruar në specifikimet teknike të sistemit të qarkullimit të ajrit. Në çdo rast standardet përkatëse SSH, ED, DIN, ose ekuivalent janë të detyrueshme. Pas mirëmbajtjes kanalet e ajrit duhet të jenë të lëmuar nga brenda, nuk duhet të kenë verbime nën të gjitha kushtet e punës dhe pa humbje presioni.

2.5.1.2 Testimi pas mirëmbajtjes të kanaleve të ajrit

Pas procesit të mirëmbajtjes, të gjitha kanalet e ajrit (furnizimi dhe kthimi) duhet të testohen dhe të jenë hermetike në mënyrë të tillë që i gjithë sistemi, duke përfshirë edhe lidhjet fleksibël me njësitë fundore të ajrit të mos kenë rrjedhje më shumë se 4% të sasisë maksimale të projektuar të ajrit në presionin statik në kushtet e punës të kanalit të ajrit.

2.5.1.3 Mirëmbajtja e filtrave të ajrit

Mirëmbajtja e filtrave të ajrit parashikon pastrimin me solucione dhe zëvendësimin e filtrave të thatë të ajrit. Në qoftë se pas pastrimit filtri dëmtohet ai duhet të zëvendësohet. Gjatë periudhës 3 vjeçare të përdorimit duhen zëvendësuar të gjithë filtrat e kanaleve të ajrit me të rinj. Pas pastrimit/zëvendësimit filtri duhet të puthitet plotësisht në skeletin mbajtës dhe nuk duhet të lejojë kalime të ajrit anash tij. Filtrat duhet të jenë të lëvizshëm nga ana e sipërme e rrjedhjes së ajrit në mënyrë që drejtimi i presionit të ajrit të veprojë kundër guarnicioneve.

2.5.2 SISTEMI I KONDICIONIMIT DHE VENTILIMIT

Funksionimi i sistemit të ventilimit është i programuar dhe starton me kronometër. Parametrat individualë për çdo impiant duhet të jenë të përcaktuara. Meqenëse është i mundur kontrolli për ftohjen gjatë natës përmes ajrit të jashtëm në opsionin “free cooling” ventilimi përmes rikuperatorëve duhet kontrolluar në vartësi të temperaturës gjatë natës. Kufijtë nominale duhet të përcaktohen në mënyrë të veçantë për çdo funksionim dhe impiant.

I gjithë sistemi i ventilimit duhet të mbyllet automatikisht në rast zjarri në dhomën e impiantit ose në zonat e okupuara ku zjarri do të identifikohet nga sistemi i zbulimit të zjarrit.

2.5.2.1 Ventilatorët

Gjatë mirëmbajtjes motori i ventilatorit do të kontrollohet në mënyrë periodike nga mbrojtja e mbingarkesave. Mirë-funksionimi si dhe rastet e defekteve do të përfshihen në kontrollin automatik të pajisjes me drejtimin për në derën e panelit. Për të gjithë motorët që punojnë me rripa transmisioni V, duhet të instalohet kontrolli i rripit V. Në raste të shpëputjes së rripit të transmisionit, impianti do të dalë jashtë pune, dhe do të bjerë alarmi në sistemin e menaxhimit dhe tek teknikët me anë të modemit SMS. Furnizimi me energji elektrike i motorëve të ventilatorëve duhet të ndërpritet me anë të çelësit kryesor (i mbyllur), i pozicionuar në kasën e motorit ose në afërsi të tij.

2.5.2.2 Njësitë e Brendshme – kontrolli në dhoma

Të gjitha zyrat dhe sallat do të kontrollohen nga EIB/Konnex ose ekuivalent me disa kontrolle në dhoma të FCU (fan-coil). Sistemi i fan-coil-ave është një sistem me 3 tuba dhe si e tillë duhen kontrolluar pultet e komandimit për regjimin ngrohës/ftohës të cilat mundësisht të

jenë në të njëjtin regjim. Valvula kryesore që ndryshon proceset nga ngrohje në ftohje, do të drejtohet nga BMS sipas kërkesave, temperaturës së jashtme dhe kohëmatësit vjetor.

2.5.2.3 Njësitë e Jashtme – kontrolli në taracë

Të gjitha njësitë e jashtme kanë kontrollin periodik 1 (një) herë në javë. Sistemi i Njësive VRV është një sistem me 3 tuba dhe si e tillë duhen kontrolluar pultet e komandimit për regjimin ngrohës/ftohës të cilat mundësisht të jenë në të njëjtin regjim me njësitë e brendshme. Valvula kryesore që ndryshon proceset nga ngrohje në ftohje, do të realizohet sipas kërkesave, temperaturës së jashtme dhe kohëmatësit vjetor.

3 Kërkesat bazë të “Skuadrës së Mirëmbajtjes”

Sistemi VRV në ndërtesën e Kryeministrisë është praktikisht i teknologjisë më të fundit të viteve 2018-2019 dhe si e tillë kërkon një program të përgjithshëm menaxhimi me qëllim që të trajtojë organizimin, organikën, planifikimin dhe kontrollin e funksionimit dhe mirëmbajtjes. Mirëmbajtja e sistemit teknik të sistemit VRV është përgjegjësi e një personeli teknik të trajnuar për teknologjinë e ngrohje/ftohjes dhe që përfaqëson skuadër të kualifikuar dhe të trajnuar. Si e tillë “Skuadra e Mirëmbajtjes” duhet të ketë të garantuar se trajnimet për mirëmbajtjen dhe operimin e këtyre pajisjeve nga një shitës i autorizuar i lidhur me prodhuesin e makinave të vendosura në këtë sistem, qoftë në nivelin inxhinierik, por edhe në atë teknik i mesëm.

3.1.1 Plani i menaxhimit të mirëmbajtjes

Një plan menaxhimi mirëmbajtjeje i mirë përfshin analiza kostosh të sakta si dhe siguron që komforti i okupantëve të rëndësisë së veçantë, planifikimi i energjisë si dhe sistemet e mbrojtjes dhe sigurisë, të jenë optimale për të gjitha pajisjet.

Gjatë menaxhimit të mirëmbajtjes së sistemit AC në KM duhet të përfshihen çështjet e mëposhtme:

- Efektshmëria e kostove të mirëmbajtjes;
- Marrja në dorëzim e punimeve rutinë të mirëmbajtjes nga Autoriteti;
- Mundësitë e menaxhimit të kohës së ekzekutimit të mirëmbajtjes të lidhur ngushtë me kohën e punës në zyra dhe mjedise të ndërtesës në raport me ndalimin e përkohshëm për efekt mirëmbajtjeje zonale të sistemit AC (korridore, kohë jashtë kohës së punës, fund jave, festa, etj);
- Mbajtja e dokumentacionit dhe e regjistrimeve të ndërhyrjeve mirëmbajtëse sipas protokolleve të përcaktuara në manualet e pajisjeve të prodhuesit;
- Ndarja e përgjegjësisë për shërbimet ndaj pajisjeve të ndara sipas thellësisë (cilësisë) të ndërhyrjes. Kjo do të thotë se, në dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, duhet të identifikohen operacionet e punës që kryhen nga stafi i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve dhe operacione të cilat mund të kryhen nga staf teknik i trajnuar.

3.1.2 Dokumentacioni për protokollet e mirëmbajtjes

Dokumentacioni për protokollet e funksionimit dhe mirëmbajtjes duhet të përpilohen në përputhje me “Manualet për funksionimin dhe mirëmbajtjen” që shoqëron çdo pajisje:

DAIKIN IV VRV (ose ekuivalente)	Sasia (njësi)
Njësi të brendshme incasso 5,6 -8,0 kË	21

Njësi të brendshme kanalore 7,1- 25,0 kË	32
Njësi të brendshme kasetë 3,6-16,5 kË	226
Njësi të brendshme tokësore 2,8-8,0 kË	3
Njësi të jashtme VRV 13,4-63,0 kË	35
Rekuperator ajri	14

Informacioni lidhur me këto pajisje gjendet në dosjen e dorëzuar pas përfundimit të punimeve dhe vënies në punë të sistemit Daikin IV VRV dhe Toshiba VRV (ose ekuivalente). Ofertuesit duhet të kenë një paketë të plotë të dokumentacionit të funksionimit dhe mirëmbajtjes që konsiston në dokumentat e mëposhtëm:

Dosja (ëeb access) e dokumentave të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Kjo direktori/dosje duhet të sigurojë akses në dokumentacionet që përmbajnë informacione të ndryshme në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit. Gjithashtu ky informacion duhet të jetë i mirë organizuar dhe lehtësisht i identifikueshëm.

Informacionin në rast emergjencash. Informacioni në rast emergjencash duhet të jetë i disponueshëm në situata emergjente dhe duhet të përmbajë procedura emergjente si dhe staf përkatës.

Manualet funksionues. Manuali i funksionimit të sistemit të ndërtesës duhet të përmbajë:

- I. Informacion të përgjithshëm
 - a) Funksionin e ndërtesës
 - b) Përshkrimin e ndërtesës
 - c) Ditaret dhe standardet e punës
- II. Informacioni teknik
 - a) Përshkrimi i sistemit
 - b) Procedurat rutinë
 - c) Start-up dhe shut-doën (nisjet dhe ndalimet) sezonale
 - d) Procedurat speciale
 - e) Defektet bazë

Manuali i mirëmbajtjes duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- I. Fletët e punës “as build” me të dhënat e pajisjeve
 - a) Të dhëna të përgjithshme
 - b) Garancinë
- II. Informacione mbi programin e mirëmbajtjes
 - a) Të dhëna mbi instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen
 - b) Inventarizimin e pjesëve të ndërrimit
 - c) Veprimet mbrojtëse të mirëmbajtjes (kujdesin ndaj goditjeve elektrike)
 - d) Grafikon e ndërhyrjeve të mundshme
 - e) Përshkrimin e veprimeve ndërhyrëse
 - f) Historikun e ndërhyrjeve mirëmbajtëse

Procesverbalet e testeve. Procesverbalet e testeve pasi është kryer mirëmbajtja duhet të dokumentojnë performancën e vrojtuar gjatë start-up-eve si dhe bëjnë të mundur përpilimin e mbarëvajtjes së punës gjatë jetëgjatësisë së pajisjeve të brendshme dhe sidomos atyre të jashtme.

Dokumentet ndërtimore. Në këtë dokumentacion duhet të përfshihen edhe kopje të dokumentave ndërtimore mbi të cilat është vendosur sistemi AC me përmasa të fletëve të punës.

Të gjithë dokumentacionet e mësipërme duhet të jenë në dispozicion të çdo departamenti pajisjesh.

3.1.3 Menaxhimi i mirëmbajtjes

Me termin “Menaxhimi i mirëmbajtjes” kuptohet planifikimi, zbatimi dhe kontrolli i veprimeve të mirëmbajtjes.

Tre tipet e programit të mirëmbajtjes që mund të adoptohen në ndërtesën e KM janë:

- 1) **mirëmbajtje parashikuese** – është mirëmbajtje e cila bazohet në monitorimin e pajisjeve dhe në tregues të gjendjes dhe performancës për të përcaktuar intervalet riparuese. Këtë situatë e parashikon sistemi IT i kontrollit me softëare të Daikin ose ekuivalente.
- 2) **mirëmbajtje parandaluese** – është rasti kur mirëmbajtja është plotësisht e programuar.
- 3) **punë deri në avari** – është rasti kur deri sa të japë defekt të rëndë dhe në këtë rast nuk shpenzohen para deri sa pajisja të krijojë avari e puna të ndërpritet.

Të tre këto grupe mirëmbajtjesh kanë nivele të ndryshme ndërhyrjeje, nga më të përciptat deri tek më të detajuarat. Kostot e mirëmbajtjes përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të kostos funksionuese të një pajisjeje, për këtë arsye menaxhimi sa më efektiv i mirëmbajtjes është mjaft i rëndësishëm.

3.1.4 Trajnimet dhe aftësitë e “Skuadrës së mirëmbajtjes”

Funksionimi dhe mirëmbajtja e sistemit të AC në ndërtesën e rëndësishme së veçantë të Kryeministrisë, kërkojnë një staf me kombinimin e duhur të aftësive teknike dhe menaxheriale. Aftësitë teknike këtu nuk përfshijnë vetëm njohuritë mbi funksionimin dhe mirëmbajtjen mekanike, por gjithashtu përfshijnë edhe njohuritë inxhinierike të vetë mekanikut që do të qëndrojnë pranë impiantit. Aftësitë menaxheriale përfshijnë menaxhimin e pajisjeve gjatë periudhës së jetëgjatësisë së saj si dhe menaxhimin ditor të pajisjes.

Vënia në punë dhe operimi i përditshëm është një nivel menaxhimi relativisht i ulët. Ndërsa kontraktimi i kompanive mirëmbajtëse duhet të sigurojë një nivel tjetër menaxhimi mirëmbajtje. Kjo është kërkuar për sistemin e AC në KM.

3.1.5 Sistemet KOMPLEKSE të ndërtesës së KM

Ndërtesat e natyrës si Kryeministria, duke përfshirë këtu 49 impiante qendrore, kërkojnë një strukturë menaxheriale komplekse. Kjo ndërtesë ka nevojë për dy stafe të veçanta:

1. njëri staf është personeli i cili do të vinte në punë e ***do të kujdesej çdo ditë për pajisjet e sistemin në tërësi dhe duhet të qëndrojë i gatshëm.***
2. stafi tjetër do ishte ai ***i mirëmbajtjes më të thelluar*** dhe duhet të jetë i gatshëm sipas skedulit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në total kontraktori i mundshëm është përgjegjës direkt, qoftë për punët e përditshme (stafi në pikën 1), qoftë për punë më të specializuara (stafi në pikën 2)

Buxheti për këto dy raste është preventivuar të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur, gjithashtu programet e kompjuterizuara të mirëmbajtjes, programe të cilat detajojnë në mënyrë të hollësishme intervalet e duhura të procedurave të mirëmbajtjes së sistemit në mënyrë që të gjithë sistemet të operojnë me efikasitet maksimal, ndërsa ruajnë komfortin e okupantëve të ndërtesës.

Në këtë kontekst, meqenëse çdo pajisje e vendosur në këtë ndërtesë është investim afatgjatë, çdo gjetje rreth këtyre kostove fillestare duhet të gërshetohet si me koston e jetëgjatësisë së kësaj pajisjeje dhe me aftësinë që ka kjo pajisje për të përmbushur kërkesat e komfortit të okupantëve, ndërsa është në vëmendje për të përdorur një bilanc të arsyeshëm energjie i cili do të auditohet.

3.1.6 Monitorimi i gjendjes së pajisjeve

Një aspekt i rëndësishëm i funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve inxhinierike AC të montuara dhe të vëna në punë në ndërtesën e KM është kontrolli ose vlerësimi i gjendjes së pajisjes. Për sistemet komplekse sikurse edhe në këtë ndërtesë historike, mund të jetë e nevojshme monitorimi njëherazi i disa kushteve ose gjendjeve të tilla si temperatura, vibrimet nga lidhjet, si dhe ngarkesave në mënyrë që të bëhet një vlerësim i gjendjes së përgjithshme.

- Një nga praktikatat më efektive të monitorimit të gjendjes së sistemit AC në ndërtesën e KM është kontrolli rutinë i funksionimit të impiantit i kryer nga një teknik gjatë kontrolleve të rregullta dhe plotësisht të skeduluara që planifikohen t'i bëhen impiantit gjatë regjimit ditor të tij. Njohuritë që mund të ketë ky teknik së bashku me eksperiencën dhe familjaritetin e tij me impiantin janë elemente të paçmueshëm në diagnostikimin e gjendjes së impiantit në fjalë.
- Parametrat apo gjendja fizike mund të maten në mënyrë objektive dhe në kohë reale duke përdorur pajisje speciale (metoda fizike) ose vetëm sensorët e përgjithshëm të sistemit menaxhues të ndërtesës përmes kompjuterit dhe programit kompjuterik të miratuar nga prodhuesi. Një parametër i gjendjes fizike të tillë, siç është vibrimi në kushinetat e elementeve rrotullues, mbushja me pluhur, sasia e limituar e ajrit, etj., janë elemente të cilat duhet të monitorohen dhe mirëmbahen në vend afër pajisjes. Të tjerat, si prodhimi i të ngrohtit, të ftohtit, temperatura, gjendja në punë apo jo, janë pjesë e programit kompjuterik .

Në rastin e ndërtesës të KM nevojiten domosdo disa parametra për një problem të caktuar, për shembull, për të përcaktuar shkallën e ndotjes së filtrit të ajrit në një sistem VAV, pra me volum të ndryshueshëm të ajrit, është e nevojshme të matet presioni diferencial përgjatë filtrit dhe të interpretohet me pas në terma të rrymës aktuale që kalon përmes filtrit. Kjo mund të bëhet ose duke e lënë të punojë ventilatorin në shpejtësinë maksimale dhe më pas të matet presioni diferencial ose duke kombinuar një sinjal të vlerës së rrymës me një sinjal të presionit diferencial. Këtë situatë duhet ta monitorojë automatikisht sistemi i kompjuterizuar.

Teknika të tjera monitoruese të parametrave të punës duhet të jenë:

- (1) përdorimi i imazheve termike infra të kuqe të lidhjeve elektrike për të përcaktuar nëse lidhjet mekanike janë të shtrënguara aq sa duhet apo jo,
- (2) analizimi i rrymës elektrike për të diagnostikuar problemet në bobinat e motorit,

- (3) matja e presionit diferencial përgjatë hapësirës së filtrit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë për të përcaktuar intervalet optimale të pastrimit apo ndërrimit, pasi të jetë dhënë sinjali se filtri është i ngarkuar me pluhura të ajrit,
- (4) matja e diferencës së temperaturës brenda dhe jashtë për një përgjigje sa më të saktë të ngarkesës termike të pompës së nxehtësisë.

3.2 PARASHIKIME TË PROJEKTIT TEKNIK DHE MIRËMBAJTJA

3.2.1 Njohja me të dhënat e detyrës së projektimit.

Lidhur me procesin e mirëmbajtjes duhet të konsiderohet (të njihet) Detyra e projektimit e cila, në raport me mirëmbajtjen përmban elemente të cilat duhet të konsiderohen nga ekipi i menaxhimit të mirëmbajtjes:

- Të dhëna të përgjithshme të projektit.
- Qëllimi i projektit dhe zgjedhja e sistemit sipas Projekt idesë.
- Detyrat që zgjidh projekti.
- Vendosja e një sistemi teknik eficient.
- Llogaritjet për fuqinë e instaluar të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit.
- Vlerësimi i ngarkesës termike në dy sezona. Skema e zgjedhur dhe zgjidhja në projekt.
- Parametrat e projektimit për komfortin. Kushtet e brendshme projektuese.
- Temperatura projektuese. Kapaciteti maksimal i pajisjeve në raport me klimën e jashtme.
- Sasitë e ajrit ventilues.
- Sistemit elektrik mbështetës për furnizimin e njësive të jashtme dhe të brendshme.
- Specifikimet teknike të pajisjeve të vendosura. Njohja me kodet dhe manualët e përdorimit.
- Projekti “as build”, numri i fletëve dhe relacioni shoqërues.
- Raportimi në autoritetin kontraktor.
- Kriteret e kapaciteteve profesionale të operatorit ekonomik që ka ndërtuar.

3.3 Reagimi i sistemit përmes alarmeve për anomalitë ose keq-funksionimi

Më poshtë janë dhënë alarmet që shfaq sistemi gjatë punës dhe është e domosdoshme ndërhyrja e specializuar nga mirëmbajtësi. Adresimi i tyre bëhet vetëm nga skuadra e mirëmbajtjes!

Tabela e alarmeve të njësive të brendshme

<i>Emërtimi i keqfunksionimit (anomalisë) me alarm</i>	<i>Alarmi</i>
Anomalitë e pajisjes mbrojtëse të jashtme.	A0
Anomalitë e Kabllit elektrik të fuqisë PCB ³ -së.	A1
Anomalitë e sistemit të kontrollit të nivelit të kullimit (SIL).	A3
Bllokim i motorit të ventilatorit (M1F), mbingarkesë.	A6
Anomali e motorit të ventilatorit të njësisë së brendshme.	A6
Mbingarkesa e tepërt/kyçja e motorit të ventilatorit të njësisë së brendshme.	A6
Anomalitë e motorit të rrotullimit të ventilatorit(M1S).	A7
Anomalitë e tensionit të furnizimit me energji elektrike.	A8

³ PCB – Power Cable (kabëll fuqie elektrike)

Anomali e pluhurit të spirales së valvulës elektronike të zgjerimit.	A9
Anomali e spirales së valvulës së zgjerimit elektronik.	A9
Niveli i drenazhit mbi kufirin e lejuar.	AF
Anomali të pajisjes për përcaktimin e kapacitetit.	AJ
Anomali në transmetim ndërmjet PCB-së së njësisë së brendshme dhe PCB-së së ventilatorit.	C1
Anomali e termistorit të tubit të lëngshëm të këmbyesit të nxehtësisë.	C4
Anomalia e termistorit të tubit të gazit të këmbyesit të nxehtësisë.	C5
Gabim kombinimi midis PCB-së së njësisë së brendshme dhe PCB-së së ventilatorit.	C6
Anomali të termistorit të thithjes së ajrit.	C9
Anomali e sensorit në distancë.	C9
Anomali të termistorit.	CA
Anomali të sistemit të sensorit të lagështisë.	CC
Termistori i temperaturës së dhomës në anomali të telekomandës.	CJ

Tabela e alarmeve të njërive të Jashtme

<i>Emërtimi i keqfunksionimit (anomalisë) me alarm</i>	<i>Alarmi</i>
Anomali të PCB-së.	E1
Aktivizimi i ndërprerësit me presion të lartë.	E3
Aktivizimi i sensorit të presionit të ulët.	E4
Bllokimi i motorit të kompresorit INV.	E5
Alarmi i dëmtimit të kompresorit.	E6
Anomali e motorit të ventilatorit të njësisë së jashtme.	E7
Anomali e spirales së valvulës së zgjerimit elektronik.	E9
Anomali të temperaturës së tubit të shkarkimit.	F3
Alarmi i lagësht.	F4
Ftohësi është mbingarkuar.	F6
Anomali të mbulesës (mes PCB-së së kontrollit dhe PCB-së së inverterit).	H3
Anomali e sinjalit të motorit të ventilatorit të njësisë së jashtme.	H7
Anomali të termistorit të ajrit të jashtëm (R1T).	H9
Anomali të termistorit të tubit të shkarkimit (R21T, R22T, R2T). Anomali e termistorit të temperaturës së sipërfaqes së kompresorit (R14T).	J3
Anomali e termistorit të thithjes së kompresorit (R12T). Anomali e termistorit thithës të ajrit (R10T).	J5
Anomali e termistorit të ngrirësit të shkëmbyesit të nxehtësisë (R11T). Anomali e termistorit të tubit të gazit të këmbyesit të nxehtësisë (R8T, R9T).	J6
Anomali e termistorit të hyrjes së marrësit (R13T). Anomali e termistorit të tubit të lëngshëm të këmbyesit të nxehtësisë nënftohëse (R7T).	J7
Anomali e termistorit të tubit të lëngshëm të këmbyesit të nxehtësisë (R4T, R5T).	J8
Anomali e termistorit të tubit të gazit të shkëmbyesit të nxehtësisë nënftohëse (R6T). Anomali e termistorit të pastrimit të gazit të marrësit (R13T).	J9
Anomali të sensorit të presionit të lartë.	JA
Anomali të sensorit të presionit të ulët.	JC
Anomali të PCB-së së inverterit.	L1
Anomali të rritjes së temperaturës së reaktorit.	L3
Anomali të rritjes së temperaturës së skajit të rrezatimit të inverterit.	L4
Mbirryma e menjëhershme e kompresorit INV ⁴ .	L5

⁴ INV - Inverteri

Mbirryma e kompresorit INV.	L8
Anomali në fillimin e kompresorit INV.	L9
Gabim transmetimi midis inverterit dhe PCB-së së kontrollit.	LC
Mosbalancimi i tensionit të furnizimit me energji elektrike.	P1
Anomali të temperaturës së reaktorit.	P3
Anomali e temperaturës së skajit të rrezatimit të inverterit.	P4
Vendosja në terren pas zëvendësimit të anomalisë kryesore të PCB-së së njësisë së jashtme ose kombinimit të anomalive të PCB-së.	PJ

Tabela e alarmeve të Sistemit (mes njësive të jashtme/brendshme të lidhura)

<i>Emërtimi i keqfunksionimit (anomalisë) me alarm</i>	<i>Alarmi</i>
Mungesa e ftohësit.	U0
Faza e kundërt, faza e hapur.	U1
Furnizimi me energji i pamjaftueshëm ose anomali e menjëhershme.	U2
Operacioni i kontrollit nuk është ekzekutuar.	U3
Gabim transmetimi midis njësive të brendshme dhe njësive të jashtme.	U4
Gabim transmetimi midis telekomandës dhe njësisë së brendshme.	U5
Gabim transmetimi midis njësive të jashtme.	U7
Gabim transmetimi midis telekomandës kryesore dhe nën telekomandë.	U8
Gabim transmetimi midis njësive të brendshme dhe të jashtme në të njëjtin sistem.	U9
Kombinim jo i duhur i njësive të brendshme dhe të jashtme, njësive të brendshme dhe telekomandës.	UA
Adresoni dyfishimin e pajisjeve të kontrollit të centralizuar.	UC
Gabim transmetimi midis pajisjeve të kontrollit të centralizuar dhe njësisë së brendshme.	UE
Sistemi nuk është vendosur ende.	UF
Anomali të sistemit, adresa e sistemit të ftohësit e papërcaktuar.	UH

3.4 Protokollet e mirëmbajtjes

Protokollet e mirëmbajtjes janë përshkruar më poshtë sipas sistemeve të ndara në:

1. Njësitë e brendshme.
2. Njësitë e jashtme.
3. Rikuperatorët e nxehtësisë.

Modeli minimal i kontrollit të pajisjeve jepet në tabelat e mëposhtme:

Fleta e kontrollit të njësisë së jashtme

Instaluesi		
Shoqëria		
Personi i kontaktit		
Klienti	Kryeministria	
Emri i përfaqësuesit		
Adresa		
Informacion i përgjithshëm		
Kontrolli i zhvilluar nga:		
Shoqëria		
Tekniku		
Certifikata		
Datë		
Mirëmbajtja		
Njësia e Jashtme	Gjendja	Veprimi i kryer
Këmbyesi i nxehtësisë	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo në rregull	<input type="checkbox"/> u pastrua
Depozita e drenazhit	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo në rregull	<input type="checkbox"/> u pastrua
PCB i nxehur	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo në rregull	<input type="checkbox"/> u pastrua <input type="checkbox"/> nuk aplikohet
Gjendja e jashtme e pajisjes	<input type="checkbox"/> e pastër	<input type="checkbox"/> u pastrua
Gjendja brenda pajisjes	<input type="checkbox"/> e pastër	<input type="checkbox"/> u pastrua
Kabllo e shtrënguara në kontaktet	<input type="checkbox"/> OK	<input type="checkbox"/> jo OK
Qarkullimi i lirë i ajrit	<input type="checkbox"/> OK	<input type="checkbox"/> jo OK

Fleta e kontrollit të njësisë së brëndshme

Njësia e brëndshme	Gjendja	Veprimi i kryer
Instaluesi		
Shoqëria		
Personi i kontaktit		
Klienti		
Kryeministria		
Emri i përfaqësuesit		
Adresa		
Informacion i përgjithshëm		
Kontrolli i zhvilluar nga:		
Shoqëria		
Tekniku		
Certifikata		
Datë		
Mirëmbajtja		
Njësia e Brëndshme	Gjendja	Veprimi i kryer
Filtri i ajrit	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo në rregull	<input type="checkbox"/> u pastrua/zëvendësua
Këmbyesi i nxehtësisë	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo në rregull	<input type="checkbox"/> u pastrua
Depozita e drenazhit	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo në rregull	<input type="checkbox"/> u pastrua
Ventilatori fletët/motori	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo në rregull	<input type="checkbox"/> u pastrua
Gjendja jashtë pajisjes	<input type="checkbox"/> e pastër	<input type="checkbox"/> u pastrua
Gjendja brenda pajisjes	<input type="checkbox"/> e pastër	<input type="checkbox"/> u pastrua
Kabllo e shtrënguara në kontaktet	<input type="checkbox"/> OK	<input type="checkbox"/> jo OK
Qarkullimi korrekt i ajrit	<input type="checkbox"/> OK	<input type="checkbox"/> jo OK
Telekomanda – bateritë	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> nuk aplikohet	<input type="checkbox"/> jo OK

Fleta e kontrollit të njësisë rikuperuese

Njësia e brëndshme	Gjendja	Veprimi i kryer
Instaluesi		
Shoqëria		
Personi i kontaktit		
Klienti		
Kryeministria		
Emri i përfaqësuesit		
Adresa		
Informacion i përgjithshëm		
Kontrolli i zhvilluar nga:		
Shoqëria		
Tekniku		
Certifikata		
Datë		
Mirëmbajtja		
Rikkuperatori nxehtësisë	Gjendja	Veprimi i kryer
Filtri i ajrit	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo OK	<input type="checkbox"/> u pastrua/zëvendësua
Rikuperatori i nxehtësisë/kembyesi	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo OK	<input type="checkbox"/> u pastrua
Këmbyesi i nxehtësisë	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo OK	<input type="checkbox"/> u pastrua
Depozita e drenazhit	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo OK	<input type="checkbox"/> u pastrua
Ventilatori fletët/motori	<input type="checkbox"/> e pastër <input type="checkbox"/> jo OK	<input type="checkbox"/> u pastrua
Gjendja jashtë pajisjes	<input type="checkbox"/> e pastër	<input type="checkbox"/> u pastrua
Gjendja brenda pajisjes	<input type="checkbox"/> e pastër	<input type="checkbox"/> u pastrua
Kabllo e shtrënguara në kontaktet	<input type="checkbox"/> OK	<input type="checkbox"/> jo OK
Qarkullimi korrekt i ajrit	<input type="checkbox"/> OK	<input type="checkbox"/> jo OK

4 Mirëmbajtja e thelluar me ndërhyrje nga defekte të rënda

4.1 Ndërhyrjet emergjente për shkak të defekteve të rënda.

Pas daljes nga garancia të sistemit të kondicionimit në KM është e domosdoshme të parashikohet një situatë emergjente e cila do të çonte në ndalimin e pjesshëm të sistemit dhe një situatë e cila mund të tejkalohet përmes prokurimit të pjesëve të ndërrimit të sistemit me qëllim zëvendësimin e tyre.

Kjo situatë mund të vazhdojë deri sa sistemi i prokurimeve të këtyre pajisjeve të kryejë procedurat ligjore dhe mund të shkaktojë vonesa deri në disa javë apo muaj.

Për t'i dalë përpara këtyre procedurave të zgjatura, më poshtë është parashikuar se cilat mund të jenë pajisjet, materialet dhe kostot e tyre që mund të çojnë në situata të tilla:

1. Funizim. Vendosije. Njesi e jashtme pompe nxehtesie Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 28 deri 37.5 kË
2. Funizim. Vendosije. Njesi e jashtme pompe nxehtesie Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 40 deri 50 kË
3. Funizim. Vendosije. Njesi e jashtme pompe nxehtesie Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 50 deri 63 kË
4. Funizim. Vendosije. KOMPRESORI i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 28-37.5
5. Funizim. Vendosije. KOMPRESORI i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 40-50
6. Funizim. Vendosije. KOMPRESORI i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 50-63
7. Funizim. Vendosije. VENTILATORI i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 28-37.5 kË
8. Funizim. Vendosije. VENTILATORI i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 40-50 kË
9. Funizim. Vendosije. VENTILATORI i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent te sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 56-63 kË
10. Funizim. Vendosije. Kembyesi i nxehtesise i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent, sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 28-37.5 kË
11. Funizim. Vendosije. Kembyesi i nxehtesise i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent, sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 40-50 kË
12. Funizim. Vendosije. Kembyesi i nxehtesise i njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent, sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 56-63 kË

13. Funizim. Vendosije. Valvola ekspansioni, filtra, tabela e komandes dhe Materiale të imta montimi te njesise se jashtme Daikin ose ekuivalent, sistemit VRV -fuqia ftohese/ngrohese 11-165 kw
14. Funizim. Vendosije.Njese e brendshme kasete DAIKIN ose ekuivalentie, fuqia ftohese 3.6 deri 5.6 KW, fuqia ftohese 4.0 deri 6.3 kw, e pajisur me sensor distance, pompe kondense, sitem pastrimi automatik dhe sinjalizues per zbrazjen e depozites se mbetjeve
15. Funizim. Vendosije.Njese e brendshme kasete DAIKIN ose ekuivalentie, fuqia ftohese 7.1 deri 9.0 KW, fuqia ftohese 8.0 deri 10 kw, e pajisur me sensor distance, pompe kondense, sitem pastrimi automatik dhe sinjalizues per zbrazjen e depozites se mbetjeve
16. Funizim. Vendosije.Njese e brendshme konsol DAIKIN ose ekuivalentie, fuqia ftohese 3.6 deri 5.6 KW, fuqia ftohese 4.0 deri 6.3 kw, e pajisur me sensor distance, pompe kondense, sitem pastrimi automatik dhe sinjalizues per zbrazjen e depozites se mbetjeve
17. Funizim. Vendosije.Njese e brendshme konsol DAIKIN ose ekuivalentie, fuqia ftohese 7.1 deri 9.0 KW, fuqia ftohese 8.0 deri 10 kw, e pajisur me sensor distance, pompe kondense, sitem pastrimi automatik dhe sinjalizues per zbrazjen e depozites se mbetjeve
18. Funizim. Vendosije.Njese e brendshme konsol inkaso DAIKIN ose ekuivalentie, fuqia ftohese 3.6 deri 5.6 KW, fuqia ftohese 4.0 deri 6.3 kw, e pajisur me sensor distance, pompe kondense, sitem pastrimi automatik dhe sinjalizues per zbrazjen e depozites se mbetjeve
19. Funizim. Vendosije.Njese e brendshme konsol inkaso DAIKIN ose ekuivalentie, fuqia ftohese 7.1 deri 9.0 KW, fuqia ftohese 8.0 deri 10 kw, e pajisur me sensor distance, pompe kondense, sitem pastrimi automatik dhe sinjalizues per zbrazjen e depozites se mbetjeve
20. Furnizim vendosje VENTILATOR për njesite e brendshme
21. Furnizim vendosje Pompe kondensati për njesite e brendshme
22. Furnizim vendosje Kembyes nxehtesie për njesite e brendshme
23. Furnizim vendosje sitemi i komandimit në pajisje dhe/ose komanda ëireless për njesite e brendshme
24. Funizim Vendosije. Njese rekuiperimi ajri me izolim akustik dhe termik me presion 120-150 Pa 2 000 deri 3 000 m³/h, EFICENCE 60 %
25. Furnizim.Vendosije. Pult Magjstral per komandinim e pergjithshem
26. Furnizim-vendosije gaz frigoriferik R41A

27. Vendosija e çmimeve për Furnizim dhe Vendosije të pajisjeve të klasifikuara në defektet e rënda

Pajisjet sipas listës së mësipërme klasifikohen si materiale të cilat shkaktojnë funksionimin jo normal të pajisjeve dhe në shumë raste bëjnë ndalimin e saj. Kjo situatë në tekniken e ajrit të kondicionuar klasifikohet si “defekt i rëndë” dhe lidhet drejtpërdrejt me zëvendësimin në

kushtet e emergjencës për të rivendosur në punë njësitë e brendshme, por sidomos njësinë e jashtme e cila minimalisht “lë pa punë” më shumë se 12 zyra.

III.2.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit në SPE të BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK rezulton se është paraqitur, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Leter Autorizimi leshuar nga Daikin Airconditioning Central Europe HandselsgmbH për operatorin ekonomik ECS ECO Climate Solution leshuar më datë 01.04.2023 me vlefshmëri 24 muaj nga data e lëshimit në këtë shkresë citohet “ *Menaxhimi i Daikin Airconditioning Central Europe Handels gmbHI konfirmon zyrtarisht se kompania ECS Eco Climate Solution ndodhet n&Rr. "Dritan Hoxha", Tirana Ring Center, Kati O, Tirane, Shqipëri është nje tregtar i autorizuar dhe plotësisht i rekomanduar dhe i mbeshtetur për te kryer të gjitha aktivitetet qe lidhen me DAIKIN VRV IV si dhe te gjithë portofolin e pajisjeve te ajrit te kondicionuar*

Ku autorizon për këto shërbime:-Per te Projektuar dhe inxhinieruar

-Per te Ofruar

-Per te shitur

-Per te instaluar

-Per te vene ne pune

-ne sherbim

-per te ruajtur.

Kjo leshuar në gjuhën angleze, e përkthyer dhe e noterizuar me aktin nr 157/ rep datë 12.01.2024.

III.2.4 . Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.5 . Në nenin 41, VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “1. Në procedurat e prokurimit për shërbime,

- autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.
2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.
 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.
 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:
 - a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
 - b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
 - c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
 - ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
 - d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, staf i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.
 5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:
 - a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.
 - c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.
 - ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

6. *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*
7. *Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur.*

III.2.6 . Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III 2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që “4. *Operatori ekonomik duhet të deklaroj Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.*”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “ECS Eco Climate Solution” SH.A, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin Autorizim Prodhuësi, i cili ka përmbajtje ”*Leter Autorizimi leshuar nga Daikin Airconditioning Central Europe HandselsgmbH për operatorin ekonomik ECS ECO Climate Solution leshuar më datë 01.04.2023 me vlefshmëri 24 muaj nga data e lëshimit në këtë shkresë citohet*“ *Menaxhimi i Daikin Airconditioning Central Europe Handels gmbHI konfirmon zyrtarisht se kompania ECS Eco Climate Solution ndodhet n& Rr. "Dritan Hoxha", Tirana Ring Center, Kati O, Tirane, Shqipëri është një tregtar i autorizuar dhe plotësisht i rekomanduar dhe i mbështetur për të kryer të gjitha aktivitetet që lidhen me DAIKIN VRV IV si dhe të gjithë portofolin e pajisjeve të ajrit të kondicionuar*

Ku autorizon për këto shërbime:-Per te Projektuar dhe inxhinieruar

-Per te Ofruar

-Per te shitur

-Per te instaluar

-Per te vene ne pune

-ne sherbim

-per te ruajtur.

Kjo leshuar në gjuhen angeleze, e perkthyer dhe e noterizuar me aktin nr 157/ rep datë 12.01.2024. Referuar DST përkatësisht shtojcës 7 vërehet, se kemi të bëjmë me mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin. Referuar kërkesës mbi deklaratën në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga ana e Autoritetit Kontraktor, KPP gjykon, se ndaj Operatorit ekonomik “ECS Eco Climate Solution” Sh.A, vetë kompania prodhuese ka leshuar këtë autorizim prodhuesi ndaj dhe kërkesa në lidhje me kete deklaratë vërtetohet me anë të këtij lëshimi autorizimi prodhuesi nga vetë DAIKIN Airconditioning Central Europe Handels GmbH. Pra, “ECS Eco Climate Solution” Sh.A me dokumentacionin e paraqitur/ngarkuar përmbush kërkesën e përcaktuar në pikën 2.3.4 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK ankimues qëndron.

III.3 Lidhur me kërkesën e BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK, ku në ankesë parashtron se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK nuk përmbush kriterin “Kriteret: 3 Kapaciteti teknik: *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.*

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmine përkatëse, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara*

III.3.1 Në shtojcën 8, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit në procedurën e prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

1. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.*

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmine përkatëse, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimeve të realizuara.

III.2.2. Në shtojcën 7, “Termet e Referencës në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 7

4.1.1.1.1.1.1.1.1 (Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

4.1.1.1.1.1.1.1.2 FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

5 Menaxhimi i funksionimit dhe mirëmbajtjes të sistemit VRV në ndërtesën e Kryeministrisë

5.1 Termet teknike për mirëmbajtjen e sistemit të kondicionimit tip VRV në ndërtesën e KM katet -1, 0, +1, +2.

5.1.1 Përshkrimi i kufijve të mirëmbajtjes

Në fund të vitit 2017 është përfunduar me sistem kondicionimi kati -1 ku është vendosur arkiva e Kryeministrisë dhe muzeu dhe në vitin 2019 është përfunduar dhe kolauduar sistemi i kondicionimit tip VRV në ndërtesën e Kryeministrisë, katet 0, +1, +2 me markën DAIKIN dhe zyrat qendrore të Kryeministrit me markën Toshiba.

Ndërtesa është klimatizuar me ajër të kondicionuar dhe përfshin tre kate të pjesës kryesore të ndërtesës të Kryeministrisë (KM) nga ana e bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe gjithashtu katin e minus një që është bodrumi, zyrat qendrore të Kryeministrit sipas projektit të realizuar “as build” e cila është në dokumentacionin e kolaudimit. Projekti është realizuar kufijtë e ndërtesës të cilat janë:

- Kati zero, është i klimatizuar në të gjithë sipërfaqen e godinës duke përfshirë zyrat, korridoret, hollet.
- Kati i parë (+1) përfshin me klimatizim të gjithë pjesën e godinës si zyrat qendrore të Kryeministrit, që ndodhen në anën perëndimore të godinës, hollet, korridoret, sallat e mbledhjeve dhe zyrat.
- Kati i dytë (+2) është i klimatizuar në të gjithë sipërfaqen e tij duke përfshirë hollet, korridoret, zyrat dhe sallat e mbledhjeve.
- Kati minus një (bodrumi) është i klimatizuar në pjesën perëndimore nga ana e bulevardit “Dëshmorët e Kombit”.

5.1.2 Kufijtë e sistemit AC

Mirëmbajtja e sistemit teknik të ajrit të kondicionuar, përfshin, përveçse përmirësimin e performancës energjetike të projektuar dhe të zbatuar, edhe vendosjen e kriterëve dhe protokolleve teknike të cilat sigurojnë eficiencë të lartë dhe siguri shëndetësore që klasifikohet si element thelbësor i lidhur ngushtë me mirëmbajtjen e ndërtesës historike.

Sistemi i Ngrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar në Kryeministri, është një sistem qendror i copëzuar i përbërë nga njësitë e brendshme dhe të jashtme si edhe rikuperatorët e nxehtësisë. Njësitë e brendshme dhe të jashtme lidhen përmes tubacioneve të gazit refrixherant dhe ajri shpërndahet me anë të njërive të brendshme të cilat janë tip kasetë ose kanalore. Njësitë e brendshme kanalore dhe rikuperatorët e përpunojnë ajrin e freskët ose riqarkullues përmes kanaleve të ajrit të cilat quhen ndryshe, kanale ventilimi.

Të gjitha pajisjet e ansambluara kanë fuqinë e instaluar termike 454.6kË – ngrohje dhe 349.6kË – ftohje. Makinat termike që mbajnë këtë ngarkesë janë objekt i mirëmbajtjes sipas kateve, përfshirë zyrën kryesore të Kryeministrit të përshkruar më lart:

KATI 0 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente) – në total 6 sisteme me 12 njësi të jashtme dhe 79 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 33,5-37,5 kË 6 copë dhe 45,0-50,0 kË 6 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kË 75 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 4 copë.

KATI +1 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente) – në total 9 sisteme me 14 njësi të jashtme dhe 87 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 28.0-33,5-37,5 kË 5 copë, 45,0-50,0 kË 8 copë dhe 56.0-63.0 1 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kË 77 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 7.1-8.0 kË 5 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 5 copë.

KATI +2 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente) – në total 7 sisteme me 13 njësi të jashtme dhe 91 njësi të brendshme nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 28.0-33,5-37,5 kË 5 copë, 45,0-50,0 kË 8 copë dhe 56.0-63.0 1 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0, 5.6-6.3 dhe 7.1-8.0 kË 71 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 7.1-8.0 kË 8 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 2 copë.

Kryeministria ndërtesa qendrore

KATI 0, +1, +2 – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin, Toshiba (ose ekuivalente) – në total 3 sisteme me 7 njësi të jashtme dhe 9 njësi të brendshme kanalore dhe 15 rikuperatorë energjie nga të cilat:

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 20.0-23,5, 13.4-15.5, kË 7 copë.
- Njësi të brendshme kanalore 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 5 copë.
- Njësi të brendshme incasso 7.1-8.0 dhe 9.0-10.0 kË 4 copë.
- Rikuperatorë energjie ajruesa 15 njësi.

KATI -1 (arkiva) – mirëmbajtje impianti VRV IV Daikin (ose ekuivalente)

- Njësi të jashtme me fuqi të instaluar 45.0-50.0kË 1 copë.
- Njësi të brendshme kasetë 4.5-5.0 dhe 5.6-6.3kË 13 copë.

5.2 Qëllimi i mirëmbajtjes

Qëllimi i mirëmbajtjes është që sistemi i kondicionimit të jetë totalisht në punë gjatë 24 orëve në 7 ditë të javës për 350 ditë të vitit (përfshirë këtu një periudhë pushimi 5 ditore). Gjithashtu, sistemi i kondicionimit me qëllim që të sigurojë rregullimin e temperaturës dhe të sasive të projektuara dhe të realizuara të ajrit të freskët në mjediset e brendshme ashtu siç është projektuar, duhet të mirëmbahet duke pastruar filtrat në mënyrë të vazhdueshme dhe duke kontrolluar mirëfunksionimin.

Ajri i freskët përmes rikuperatorëve të energjisë sigurohet të futë minimalisht rreth 25% ajër të jashtëm, i cili përpunohet në të gjithë ndërtesën së bashku me ajrin riqarkullues. Ky sistem kërkon domosdoshmërisht kontroll absolut të filtrave të ajrit në njësinë e këmbimit të nxehtësisë dhe frekuencë më të lartë të pastrimit/ndërrimit të tyre.

Kjo situatë kërkon që njësitë me rikuperim nxehtësie, përveçse të sigurojnë që të ruajnë 50-60% temperaturën (nxehtësinë) e ajrit të brendshëm që del nga rikuperatori, duhet të bëjnë ndryshimin (ose pastrimin) e filtrave në kontakt me ajrin e jashtëm, të paktën një herë në javë për 52 javë të vitit. Kështu, ajri që do të ri-qarkullojë në mjediset e ndërtesës nëpërmjet kanaleve të ajrit është e domosdoshme të përshkojë sistemin e rikuperimit të Energjisë për të ndryshuar parametrat termike, siç janë temperatura dhe lagështia e ajrit të brendshëm të përzier me ajrin e jashtëm.

5.3 Koha e punës e domosdoshme për Mirëmbajtjen e sistemit të ansambluar të kondicionimit.

5.3.1 Kërkesa minimale në ndërtesën që kondicionohet

Kryeministria (kati “-1”, “0”, “+1” “+2”), është një ndërtesë e konstruktuar në vitet 1940-1941, e tipit italian dhe me inerci të lartë termike të ruajtjes të nxehtësisë në strukturën e saj. Si karakteristikë termike kjo ndërtesë ofron muraturë të rëndë dhe një raport shumë komod mes dritareve dhe mureve rrethuese. Kjo gjë bën të mundur ruajtjen e nxehtësisë së të ngrohtit dhe të ftohtit në parametra maksimale (krahasuar me ndërtesat e “lehta” në Tiranë).

Koeficienti i masivitetit në këtë ndërtesë është 0.75, që do të thotë raporti mes volumit të okupuar (kondicionuar) dhe volumit të matur nga jashtë ndërtesës së bashku me strukturën është mjaft i lartë. Pra, 25% e volumit të ndërtesës është muraturë, e cila me ngrohjen dhe/ose freskimin e saj “ngarkohet” me nxehtësi e cila “i kthehet” ndërtesës pas një farë kohe dhe mbetet një burim nxehtësie që reflekton gjatë kohës kur impianti është në qetësi dhe/ose në rastet kur nuk funksionon për ndonjë arsye. Kjo situatë është një faktor arkitektonik dhe konstruktiv mjaft pozitiv dhe e ndihmon punën e sistemit.

Me këtë rast mund të themi se koha minimale për të “lejuar” ndërtesën në tërësi pa trajtim me kondicionim është rreth 3-6 orë, kohë gjatë së cilës duhet të reagojë skuadra e mirëmbajtjes për të riparuar një defekt të mundshëm në njësitë e brendshme dhe të jashtme.

Kështu nga analiza e bërë rezulton se:

- Koha më e shkurtër në dispozicion të riparimit të njësive të brendshme është 3 orë.
- Koha më e shkurtër në dispozicion të riparimit të njësive të jashtme është 6 orë.

Si konkluzion:

- Njësia e brendshme e tipit kasetë mund të riparohet për:
 - o 30 minuta për ndryshim filtri ajri,
 - o 1 orë për ndryshim/zhbllokim të pompës së kondensatit,
 - o 2 orë për ndryshim të paketës elektronike të marrjes së komandave ëireless,
 - o 3 orë për t’u zëvendësuar me një të re.
- Njësia e brendshme e tipit kanalor
 - o 30 minuta për ndryshim filtri ajri,
 - o 1.5 orë për ndryshim të pompës së kondensatit,
 - o 2.5 orë për ndryshim të paketës elektronike të marrjes së komandave ëireless,
 - o 4 orë për t’u zëvendësuar me një të re (paketa elektronike),
 - o 0,5 deri 1 orë për të vendosur mbulesën me karton-gips së bashku me shpatullimin, dhe 0,5 orë për lyerjen e gipsit pas tharjes së bojës.
- Rikuperatori i ajrit
 - o 30 minuta ndryshimi i filtrit të brendshëm dhe të jashtëm,

- 2 orë ndryshimi i pompës së kondensatit,
 - 2.5 orë ndryshimi i komanduesit elektronik,
 - 4 orë për të ndryshuar këmbyesin ajër-ajër,
 - 4 orë për të ndryshuar mbulesën prej gipsi,
 - 2 orë vendosja dhe lyerja e karton-gipsit.
- Njësitë e jashtme
- 40 minuta Pastrimi i këmbyesit të nxehtësisë ajër/refrixherant,
 - 20 minuta pastrimi i tavës së drenazhit të kondensatit,
 - 30 minuta këqyrja e lidhjeve elektrike dhe dëmeve,
 - 4 ditë për të ndryshuar kompresorin,
 - 2 orë vendosja në punë.

5.4 Rëndësia e mirëmbajtjes. Parimet e sigurisë të shëndetit.

Sistemi i Kondicionimit është i lidhur ngushtë me ngarkesat termike për ngrohje/ftohjen e Kryeministrisë, ngarkesë e cila jepet për të dy periudhat (Ngrrohje/Ftohje) përmes impiantit të Sistemit të Ngrrohjes dhe Ajrit të Kondicionuar për punë të vazhduar 350 ditë dhe 24/7 orë. Impianti domosdoshmërisht qëndron në gjendje pune përgjatë vitit dhe duhet të jetë në gatishmëri për 8400 orë dhe për arsye shërbimi kërkohen që ai të ndalohej të paktën 65 orë. Kështu rreth 360 nga 365 ditë të vitit (totali vjetor është 8760 orë/vit) kërkohet shërbim i thelluar 15 ditë të vitit për pjesë të veçanta të sistemit.

Nisur nga siguria për shëndetin e zyrtarëve të shërbimit civil dhe funksionit të rëndësishëm të veçantë që përfaqëson ndërtesa e Kryeministrisë parimet e mirëmbajtjes janë:

- Parimi i shëndetit përmes komfortit dhe ndryshimeve të ajrit të brendshëm me ajër të jashtëm (të freskët dhe sasinë natyrale të O₂).
- Parimi i sigurisë në punë duke larguar me ajrin të gjitha elementët e dëmshëm për shëndetin dhe aromat nga pajisjet elektronike, printerat, fotokopjet, mobiljet, mbetjet, avullimet, frymëmarrjet njerëzore, ushqimet, etj.
- Parimi i komfortit termik të temperaturës së ajrit sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë.
- Parimi i vazhdueshmërisë së punës së impiantit për 350 ditë dhe 24/7 orë.
- Parimi i reagimit të skuadrës së mirëmbajtjes në kohën e përcaktuar në paragrafin më lart.

5.4.1 Kufijtë e brendshëm të komfortit pas mirëmbajtjes

<u>Temperaturat</u>	<u>Dimër</u>	<u>Verë</u>
Në Zyra	20 ± 1°C	25 ± 1°C
Në Salla Pritje	21 ± 1°C	23 ± 1°C
Në Salla Mbledhje	23 ± 1°C	23 ± 1°C
Në Korridore	20 ± 1°C	25 ± 1°C
Lagështia relative	30-40%	60%

<u>Niveli i zhurmave</u>	<u>kriteri i zhurmave</u>
<i>I krijuar nga pajisjet e ndërtesës</i>	<i>NC 45 (Noise Criteria)</i>
<i>Në Zyra</i>	<i>NC 35</i>
<i>Në Salla Pritje</i>	<i>NC 35</i>
<i>Në Salla Mbledhje</i>	<i>NC 35</i>
<u>Sasitë e ajrit ventilues</u>	<u>parametra të sistemit</u>
<i>Zyra</i>	<i>5 l/s për person ajër i freskët</i>
<i>Tualete</i>	<i>12 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)</i>
<i>Salla Mbledhje</i>	<i>2 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)</i>
<i>Korridore</i>	<i>2 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)</i>
<i>Qarkullimi i brendshëm</i>	<i>2.0 ndërrime ajri/orë (ajër i freskët)</i>

5.5 SISTEMI KANALOR

5.5.1 Cilësia e kërkuar për materialet e vendosura për mirëmbajtjen.

Punimet që do të kontraktohen për mirëmbajtjen duhet të përfshijnë, furnizimin me pjesë ndërrimi, makineritë ngritëse, testimin, balancimin si dhe vendosjen për punë të sistemit të ajrit të kondicionuar si një i tërë sipas markës DAIKIN/Toshiba ose ekuivalente. Është detyrë e kontraktorit të mirëmbajtjes, zgjedhja e pajisjeve mbështetëse të tilla që mundësojnë realizimin e procesit të mirëmbajtjes dhe përzgjedhjes së “skuadrës së mirëmbajtjes” të aftë për të kuptuar dhe realizuar proceset e mirëmbajtjes të parashikuara në këtë raport.

Në specifikimet teknike të makinave të sistemit me ajër të Kondicionuar, instruksionet e mirëmbajtjes është e domosdoshme të respektohen duke ndjekur protokollin e parashikuar në to. Inxhinieri i zbatimit të mirëmbajtjes duhet të vendosë për pjesë ndërrimi dhe materiale të certifikuar dhe origjinale të prodhuara nga prodhuesi i pajisjeve.

Gjithashtu materialet e kanaleve të ajrit, tubacioneve, filtrave dhe pjesët e ndërrimit të njësive të jashtme dhe të brendshme duhet të jenë të njëjta me ato të vendosura aktualisht në sistemin e kondicionimit.

5.5.1.1 Sistemi i kanaleve të ajrit

Në rast të dëmtimit, por edhe nëse nuk ndryshohen nga mirëmbajtja, të gjithë kanalet e ajrit duhet të zëvendësohen/riparohen në përputhje me vizatimet “as build” të zhvilluar nga kontraktori zhvillues i sistemit të kanaleve të ajrit. Kontraktuesi i mirëmbajtjes nuk ka të drejtë të ndryshojë projektin pa lejen e autoritetit kontraktues dhe të projektuesit. Çdo ndërhyrje në kanalet e ajrit duhet të bëhet nëpërmjet dritareve/portave të lejuara në tavanin me kartongips që janë përshkruar në specifikimet teknike të sistemit të qarkullimit të ajrit. Në çdo rast standardet përkatëse SSH, ED, DIN, ose ekuivalent janë të detyrueshme. Pas mirëmbajtjes kanalet e ajrit duhet të jenë të lëmuar nga brenda, nuk duhet të kenë verbime nën të gjitha kushtet e punës dhe pa humbje presioni.

5.5.1.2 Testimi pas mirëmbajtjes të kanaleve të ajrit

Pas procesit të mirëmbajtjes, të gjitha kanalet e ajrit (furnizimi dhe kthimi) duhet të testohen dhe të jenë hermetike në mënyrë të tillë që i gjithë sistemi, duke përfshirë edhe lidhjet fleksibël me njësitë fundore të ajrit të mos kenë rrjedhje më shumë se 4% të sasisë maksimale të projektuar të ajrit në presionin statik në kushtet e punës të kanalit të ajrit.

5.5.1.3 Mirëmbajtja e filtrave të ajrit

Mirëmbajta e filtrave të ajrit parashikon pastrimin me solucione dhe zëvendësimin e filtrave të thatë të ajrit. Në qoftë se pas pastrimit filtri dëmtohet ai duhet të zëvendësohet. Gjatë periudhës 3 vjeçare të përdorimit duhen zëvendësuar të gjithë filtrat e kanaleve të ajrit me të rinj. Pas pastrimit/zëvendësimit filtri duhet të puthitet plotësisht në skeletin mbajtës dhe nuk duhet të lejojë kalime të ajrit anash tij. Filtrat duhet të jenë të lëvizshëm nga ana e sipërme e rrjedhjes së ajrit në mënyrë që drejtimi i presionit të ajrit të veprojë kundër guarnicioneve.

5.5.2 SISTEMI I KONDICIONIMIT DHE VENTILIMIT

Funksionimi i sistemit të ventilimit është i programuar dhe starton me kronometër. Parametrat individualë për çdo impiant duhet të jenë të përcaktuara. Meqenëse është i mundur kontrolli për ftohjen gjatë natës përmes ajrit të jashtëm në opsionin “free cooling” ventilimi përmes rikuperatorëve duhet kontrolluar në vartësi të temperaturës gjatë natës. Kufijtë nominale duhet të përcaktohen në mënyrë të veçantë për çdo funksionim dhe impiant.

I gjithë sistemi i ventilimit duhet të mbyllet automatikisht në rast zjarri në dhomën e impiantit ose në zonat e okupuara ku zjarri do të identifikohet nga sistemi i zbulimit të zjarrit.

5.5.2.1 Ventilatorët

Gjatë mirëmbajtjes motori i ventilatorit do të kontrollohet në mënyrë periodike nga mbrojtja e mbingarkesave. Mirë-funksionimi si dhe rastet e defekteve do të përfshihen në kontrollin automatik të pajisjes me drejtimin për në derën e panelit. Për të gjithë motorët që punojnë me rripa transmisioni V, duhet të instalohet kontrolli i rripit V. Në raste të shpëputjes së rripit të transmisionit, impianti do të dalë jashtë pune, dhe do të bjerë alarmi në sistemin e menaxhimit dhe tek teknikët me anë të modemit SMS. Furnizimi me energji elektrike i motorëve të ventilatorëve duhet të ndërpritet me anë të çelësit kryesor (i mbyllur), i pozicionuar në kasën e motorit ose në afërsi të tij.

5.5.2.2 Njësitë e Brendshme – kontrolli në dhoma

Të gjitha zyrat dhe sallat do të kontrollohen nga EIB/Konnex ose ekuivalent me disa kontrolle në dhoma të FCU (fan-coil). Sistemi i fan-coil-ave është një sistem me 3 tuba dhe si e tillë duhen kontrolluar pultet e komandimit për regjimin ngrohës/ftohës të cilat mundësisht të jenë në të njëjtin regjim. Valvula kryesore që ndryshon proceset nga ngrohje në ftohje, do të drejtohet nga BMS sipas kërkesave, temperaturës së jashtme dhe kohëmatësit vjetor.

5.5.2.3 Njësitë e Jashtme – kontrolli në taracë

Të gjitha njësitë e jashtme kanë kontrollin periodik 1 (një) herë në javë. Sistemi i Njësive VRV është një sistem me 3 tuba dhe si e tillë duhen kontrolluar pultet e komandimit për regjimin ngrohës/ftohës të cilat mundësisht të jenë në të njëjtin regjim me njësitë e brendshme. Valvula kryesore që ndryshon proceset nga ngrohje në ftohje, do të realizohet sipas kërkesave, temperaturës së jashtme dhe kohëmatësit vjetor.

6 Kërkesat bazë të “Skuadrës së Mirëmbajtjes”

Sistemi VRV në ndërtesën e Kryeministrisë është praktikisht i teknologjisë më të fundit të viteve 2018-2019 dhe si e tillë kërkon një program të përgjithshëm menaxhimi me qëllim që të trajtojë organizimin, organikën, planifikimin dhe kontrollin e funksionimit dhe mirëmbajtjes. Mirëmbajtja e sistemit teknik të sistemit VRV është përgjegjësi e një personeli teknik të trajnuar për teknologjinë e ngrohje/ftohjes dhe që përfaqëson skuadër të kualifikuar dhe të trajnuar. Si e tillë “Skuadra e Mirëmbajtjes” duhet të ketë të garantuar se trajnimet për mirëmbajtjen dhe

operimin e këtyre pajisjeve nga një shitës i autorizuar i lidhur me prodhuesin e makinave të vendosura në këtë sistem, qoftë në nivelin inxhinierik, por edhe në atë teknik i mesëm.

6.1.1 Plani i menaxhimit të mirëmbajtjes

Një plan menaxhimi mirëmbajtjeje i mirë përfshin analiza kostosh të sakta si dhe siguron që komforti i okupantëve të rëndësisë së veçantë, planifikimi i energjisë si dhe sistemet e mbrojtjes dhe sigurisë, të jenë optimale për të gjitha pajisjet.

Gjatë menaxhimit të mirëmbajtjes së sistemit AC në KM duhet të përfshihen çështjet e mëposhtme:

- Efektshmëria e kostove të mirëmbajtjes;
- Marrja në dorëzim e punimeve rutinë të mirëmbajtjes nga Autoriteti;
- Mundësitë e menaxhimit të kohës së ekzekutimit të mirëmbajtjes të lidhur ngushtë me kohën e punës në zyra dhe mjedise të ndërtesës në raport me ndalimin e përkohshëm për efekt mirëmbajtjeje zonale të sistemit AC (korridore, kohë jashtë kohës së punës, fund jave, festa, etj);
- Mbajtja e dokumentacionit dhe e regjistrimeve të ndërhyrjeve mirëmbajtëse sipas protokolleve të përcaktuara në manualet e pajisjeve të prodhuesit;
- Ndarja e përgjegjësisë për shërbimet ndaj pajisjeve të ndara sipas thellësisë (cilësisë) të ndërhyrjes. Kjo do të thotë se, në dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, duhet të identifikohen operacionet e punës që kryhen nga stafi i autorizuar nga prodhuesit e pajisjeve dhe operacione të cilat mund të kryhen nga staf teknik i trajnuar.

6.1.2 Dokumentacioni për protokollat e mirëmbajtjes

Dokumentacioni për protokollat e funksionimit dhe mirëmbajtjes duhet të përpilohen në përputhje me “Manualat për funksionimin dhe mirëmbajtjen” që shoqëron çdo pajisje:

DAIKIN IV VRV (ose ekuivalente)	Sasia (njësi)
Njësi të brendshme incasso 5,6 -8,0 kË	21
Njësi të brendshme kanalore 7,1- 25,0 kË	32
Njësi të brendshme kasetë 3,6-16,5 kË	226
Njësi të brendshme tokësore 2,8-8,0 kË	3
Njësi të jashtme VRV 13,4-63,0 kË	35
Rekuperator ajri	14

Informacioni lidhur me këto pajisje gjendet në dosjen e dorëzuar pas përfundimit të punimeve dhe vënies në punë të sistemit Daikin IV VRV dhe Toshiba VRV (ose ekuivalente). Ofertuesit duhet të kenë një paketë të plotë të dokumentacionit të funksionimit dhe mirëmbajtjes që konsiston në dokumentat e mëposhtëm:

Dosja (ëeb access) e dokumentave të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Kjo direktori/dosje duhet të sigurojë akses në dokumentacionet që përmbajnë informacione të ndryshme në lidhje me funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit. Gjithashtu ky informacion duhet të jetë i mirë organizuar dhe lehtësisht i identifikueshëm.

Informacionin në rast emergjencash. Informacioni në rast emergjencash duhet të jetë i disponueshëm në situata emergjente dhe duhet të përmbajë procedura emergjente si dhe staf përkatës.

Manualat funksionues. Manuali i funksionimit të sistemit të ndërtesës duhet të përmbajë:

III. Informacion të përgjithshëm

- a) Funksionin e ndërtesës
- b) Përshkrimin e ndërtesës
- c) Ditaret dhe standardet e punës

IV. Informacioni teknik

- a) Përshkrimi i sistemit
- b) Procedurat rutinë
- c) Start-up dhe shut-doën (nisjet dhe ndalimet) sezonale
- d) Procedurat speciale
- e) Defektet bazë

Manuali i mirëmbajtjes duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

III. Fletët e punës “as build” me të dhënat e pajisjeve

- a) Të dhëna të përgjithshme
- b) Garancinë

IV. Informacione mbi programin e mirëmbajtjes

- g) Të dhëna mbi instalimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen
- h) Inventarizimin e pjesëve të ndërrimit
- i) Veprimet mbrojtëse të mirëmbajtjes (kujdesin ndaj goditjeve elektrike)
- j) Grafikon e ndërhyrjeve të mundshme
- k) Përshkrimin e veprimeve ndërhyrëse
- l) Historikun e ndërhyrjeve mirëmbajtëse

Procesverbalet e testeve. Procesverbalet e testeve pasi është kryer mirëmbajtja duhet të dokumentojnë performancën e vrojtuar gjatë start-up-eve si dhe bëjnë të mundur përpilimin e mbarëvajtjes së punës gjatë jetëgjatësisë së pajisjeve të brendshme dhe sidomos atyre të jashtme.

Dokumentet ndërtimore. Në këtë dokumentacion duhet të përfshihen edhe kopje të dokumentave ndërtimore mbi të cilat është vendosur sistemi AC me përmasa të fletëve të punës. Të gjithë dokumentacionet e mësipërme duhet të jenë në dispozicion të çdo departamenti pajisjesh.

6.1.3 Menaxhimi i mirëmbajtjes

Me termin “Menaxhimi i mirëmbajtjes” kuptohet planifikimi, zbatimi dhe kontrolli i veprimeve të mirëmbajtjes.

Tre tipet e programit të mirëmbajtjes që mund të adoptohen në ndërtesën e KM janë:

- 4) **mirëmbajtje parashikuese** – është mirëmbajtje e cila bazohet në monitorimin e pajisjeve dhe në tregues të gjendjes dhe performancës për të përcaktuar intervalet riparuese. Këtë situatë e parashikon sistemi IT i kontrollit me softëare të Daikin ose ekuivalente.
- 5) **mirëmbajtje parandaluese** – është rasti kur mirëmbajtja është plotësisht e programuar.
- 6) **punë deri në avari** – është rasti kur deri sa të japë defekt të rëndë dhe në këtë rast nuk shpenzohen para deri sa pajisja të krijojë avari e puna të ndërpritet.

Të tre këto grupe mirëmbajtjesh kanë nivele të ndryshme ndërhyrjeje, nga më të përciptat deri tek më të detajuarat. Kostot e mirëmbajtjes përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të kostos funksionuese të një pajisjeje, për këtë arsye menaxhimi sa më efektiv i mirëmbajtjes është mjaft i rëndësishëm.

6.1.4 Trajnimet dhe aftësitë e “Skuadrës së mirëmbajtjes”

Funksionimi dhe mirëmbajtja e sistemit të AC në ndërtesën e rëndësishme së veçantë të Kryeministrisë, kërkojnë një staf me kombinimin e duhur të aftësive teknike dhe menaxheriale. Aftësitë teknike këtu nuk përfshijnë vetëm njohuritë mbi funksionimin dhe mirëmbajtjen mekanike, por gjithashtu përfshijnë edhe njohuritë inxhinierike të vetë mekanikut që do të qëndrojnë pranë impiantit. Aftësitë menaxheriale përfshijnë menaxhimin e pajisjeve gjatë periudhës së jetëgjatësisë së saj si dhe menaxhimin ditor të pajisjes.

Vënia në punë dhe operimi i përditshëm është një nivel menaxhimi relativisht i ulët. Ndërsa kontraktimi i kompanive mirëmbajtëse duhet të sigurojë një nivel tjetër menaxhimi mirëmbajtje. Kjo është kërkuar për sistemin e AC në KM.

6.1.5 Sistemet KOMPLEKSE të ndërtesës së KM

Ndërtesat e natyrës si Kryeministria, duke përfshirë këtu 49 impiante qendrore, kërkojnë një strukturë menaxheriale komplekse. Kjo ndërtesë ka nevojë për dy stafe të veçanta:

3. njëri staf është personeli i cili do të vinte në punë e **do të kujdesej çdo ditë për pajisjet e sistemin në tërësi dhe duhet të qëndrojë i gatshëm.**
4. stafi tjetër do ishte ai i **mirëmbajtjes më të thelluar** dhe duhet të jetë i gatshëm sipas skedulit të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në total kontraktori i mundshëm është përgjegjës direkt, qoftë për punët e përditshme (stafi në pikën 1), qoftë për punë më të specializuara (stafi në pikën 2)

Buxheti për këto dy raste është preventivuar të jetë i mjaftueshëm për të mbështetur, gjithashtu programet e kompjuterizuara të mirëmbajtjes, programe të cilat detajojnë në mënyrë të hollësishme intervalet e duhura të procedurave të mirëmbajtjes së sistemit në mënyrë që të gjithë sistemet të operojnë me efikasitet maksimale, ndërsa ruajnë komfortin e okupantëve të ndërtesës.

Në këtë kontekst, meqenëse çdo pajisje e vendosur në këtë ndërtesë është investim afatgjatë, çdo gjetje rreth këtyre kostove fillestare duhet të gërshetohet si me koston e jetëgjatësisë së kësaj pajisjeje dhe me aftësinë që ka kjo pajisje për të përmbushur kërkesat e komfortit të okupantëve, ndërsa është në vëmendje për të përdorur një bilanc të arsyeshëm energjie i cili do të auditohet.

6.1.6 Monitorimi i gjendjes së pajisjeve

Një aspekt i rëndësishëm i funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve inxhinierike AC të montuara dhe të vëna në punë në ndërtesën e KM është kontrolli ose vlerësimi i gjendjes së pajisjes. Për sistemet komplekse sikurse edhe në këtë ndërtesë historike, mund të jetë e nevojshme monitorimi njëherazi i disa kushteve ose gjendjeve të tilla si temperatura, vibrimet nga lidhjet, si dhe ngarkesave në mënyrë që të bëhet një vlerësim i gjendjes së përgjithshme.

- Një nga praktikat më efektive të monitorimit të gjendjes së sistemit AC në ndërtesën e KM është kontrolli rutinë i funksionimit të impiantit i kryer nga një teknik gjatë kontrolleve të rregullta dhe plotësisht të skeduluara që planifikohen t'i bëhen impiantit gjatë regjimit ditor të tij. Njohuritë që mund të ketë ky teknik së bashku me eksperiencën

dhe familjaritetin e tij me impiantin janë elemente të paçmueshëm në diagnostikimin e gjendjes së impiantit në fjalë.

- *Parametrat apo gjendja fizike mund të maten në mënyrë objektive dhe në kohë reale duke përdorur pajisje speciale (metoda fizike) ose vetëm sensorët e përgjithshëm të sistemit menaxhues të ndërtesës përmes kompjuterit dhe programit kompjuterik të miratuar nga prodhuesi. Një parametër i gjendjes fizike të tillë, siç është vibrimi në kushinetat e elementeve rrotullues, mbushja me pluhur, sasia e limituar e ajrit, etj., janë elemente të cilat duhet të monitorohen dhe mirëmbahen në vend afër pajisjes. Të tjerat, si prodhimi i të ngrohtit, të ftohtit, temperatura, gjendja në punë apo jo, janë pjesë e programit kompjuterik .*

Në rastin e ndërtesës të KM nevojiten domosdo disa parametra për një problem të caktuar, për shembull, për të përcaktuar shkallën e ndotjes së filtrit të ajrit në një sistem VAV, pra me volum të ndryshueshëm të ajrit, është e nevojshme të matet presioni diferencial përgjatë filtrit dhe të interpretohet me pas në termat e rrymës aktuale që kalon përmes filtrit. Kjo mund të bëhet ose duke e lënë të punojë ventilatorin në shpejtësinë maksimale dhe më pas të matet presioni diferencial ose duke kombinuar një sinjal të vlerës së rrymës me një sinjal të presionit diferencial. Këtë situatë duhet ta monitorojë automatikisht sistemi i kompjuterizuar.

Teknika të tjera monitoruese të parametrave të punës duhet të jenë:

- (5) *përdorimi i imazheve termike infra të kuqe të lidhjeve elektrike për të përcaktuar nëse lidhjet mekanike janë të shtrënguara aq sa duhet apo jo,*
- (6) *analizimi i rrymës elektrike për të diagnostikuar problemet në bobinat e motorit,*
- (7) *matja e presionit diferencial përgjatë hapësirës së filtrit dhe shkëmbyesve të nxehtësisë për të përcaktuar intervalet optimale të pastrimit apo ndërrimit, pasi të jetë dhënë sinjali se filtri është i ngarkuar me pluhura të ajrit,*
- (8) *matja e diferencës së temperaturës brenda dhe jashtë për një përgjigje sa më të saktë të ngarkesës termike të pompës së nxehtësisë.*

6.2 PARASHIKIME TË PROJEKTIT TEKNIK DHE MIRËMBAJTJA

6.2.1 Njohja me të dhënat e detyrës së projektimit.

Lidhur me procesin e mirëmbajtjes duhet të konsiderohet (të njihet) Detyra e projektimit e cila, në raport me mirëmbajtjen përmban elemente të cilat duhet të konsiderohen nga ekipi i menaxhimit të mirëmbajtjes:

- *Të dhëna të përgjithshme të projektit.*
- *Qëllimi i projektit dhe zgjedhja e sistemit sipas Projekt idesë.*
- *Detyrat që zgjidh projekti.*
- *Vendosja e një sistemi teknik eficient.*
- *Llogaritjet për fuqinë e instaluar të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të ajrit.*
- *Vlerësimi i ngarkesës termike në dy sezona. Skema e zgjedhur dhe zgjidhja në projekt.*
- *Parametrat e projektimit për komfortin. Kushtet e brendshme projektuese.*
- *Temperatura projektuese. Kapaciteti maksimal i pajisjeve në raport me klimën e jashtme.*

- Sasitë e ajrit ventilues.
- Sistemit elektrik mbështetës për furnizimin e njësive të jashtme dhe të brendshme.
- Specifikimet teknike të pajisjeve të vendosura. Njohja me kodet dhe manualët e përdorimit.
- Projekti “as build”, numri i fletëve dhe relacioni shoqërues.
- Raportimi në autoritetin kontraktor.
- Kriteret e kapaciteteve profesionale të operatorit ekonomik që ka ndërtuar.

6.3 Reagimi i sistemit përmes alarmeve për anomalitë ose keq-funksionimi

Më poshtë janë dhënë alarmet që shfaq sistemi gjatë punës dhe është e domosdoshme ndërhyrja e specializuar nga mirëmbajtësi. Adresimi i tyre bëhet vetëm nga skuadra e mirëmbajtjes!

Tabela e alarmeve të njësive të brendshme

Emërtimi i keqfunksionimit (anomalisë) me alarm	Alarmi
Anomalitë e pajisjes mbrojtëse të jashtme.	A0
Anomalitë e Kabllit elektrik të fuqisë PCB ⁵ -së.	A1
Anomalitë e sistemit të kontrollit të nivelit të kullimit (SIL).	A3
Bllokim i motorit të ventilatorit (MIF), mbingarkesë.	A6
Anomali e motorit të ventilatorit të njësisë së brendshme.	A6
Mbingarkesa e tepërt/kyçja e motorit të ventilatorit të njësisë së brendshme.	A6
Anomalitë e motorit të rrotullimit të ventilatorit(MIS).	A7
Anomalitë e tensionit të furnizimit me energji elektrike.	A8
Anomali e pluhurit të spirales së valvulës elektronike të zgjerimit.	A9
Anomali e spirales së valvulës së zgjerimit elektronik.	A9
Niveli i drenazhit mbi kufirin e lejuar.	AF
Anomalitë e pajisjes për përcaktimin e kapacitetit.	AJ
Anomali në transmetim ndërmjet PCB-së së njësisë së brendshme dhe PCB-së së ventilatorit.	C1
Anomali e termistorit të tubit të lëngshëm të këmbyesit të nxehtësisë.	C4
Anomalia e termistorit të tubit të gazit të këmbyesit të nxehtësisë.	C5
Gabim kombinimi midis PCB-së së njësisë së brendshme dhe PCB-së së ventilatorit.	C6
Anomalitë e termistorit të thithjes së ajrit.	C9
Anomali e sensorit në distancë.	C9
Anomalitë e termistorit.	CA
Anomalitë e sistemit të sensorit të lagështisë.	CC
Termistori i temperaturës së dhomës në anomali të telekomandës.	CJ

⁵ PCB – Poëer CaBle (kabëll fuqie elektrike)

Tabela e alarmeve të njësisë të Jashtme

Emërtimi i keqfunksionimit (anomalisë) me alarm	Alarmi
Anomali të PCB-së.	E1
Aktivizimi i ndërprerësit me presion të lartë.	E3
Aktivizimi i sensorit të presionit të ulët.	E4
Bllokimi i motorit të kompresorit INV.	E5
Alarmi i dëmtimit të kompresorit.	E6
Anomali e motorit të ventilatorit të njësisë së jashtme.	E7
Anomali e spirales së valvulës së zgjerimit elektronik.	E9
Anomali të temperaturës së tubit të shkarkimit.	F3
Alarmi i lagësht.	F4
Ftohësi është mbingarkuar.	F6
Anomali të mbulesës (mes PCB-së së kontrollit dhe PCB-së së inverterit).	H3
Anomali e sinjalit të motorit të ventilatorit të njësisë së jashtme.	H7
Anomali të termistorit të ajrit të jashtëm (R1T).	H9
Anomali të termistorit të tubit të shkarkimit (R21T, R22T, R2T). Anomali e termistorit të temperaturës së sipërfaqes së kompresorit (R14T).	J3
Anomali e termistorit të thithjes së kompresorit (R12T). Anomali e termistorit thithës të ajrit (R10T).	J5
Anomali e termistorit të ngrirësit të shkëmbyesit të nxehtësisë (R11T). Anomali e termistorit të tubit të gazit të këmbyesit të nxehtësisë (R8T, R9T).	J6
Anomali e termistorit të hyrjes së marrësit (R13T). Anomali e termistorit të tubit të lëngshëm të këmbyesit të nxehtësisë nënftohëse (R7T).	J7
Anomali e termistorit të tubit të lëngshëm të këmbyesit të nxehtësisë (R4T, R5T).	J8
Anomali e termistorit të tubit të gazit të shkëmbyesit të nxehtësisë nënftohëse (R6T). Anomali e termistorit të pastrimit të gazit të marrësit (R13T).	J9
Anomali të sensorit të presionit të lartë.	JA
Anomali të sensorit të presionit të ulët.	JC
Anomali të PCB-së së inverterit.	L1
Anomali të rritjes së temperaturës së reaktorit.	L3
Anomali të rritjes së temperaturës së skajit të rrezatimit të inverterit.	L4
Mbirryma e menjëhershme e kompresorit INV ⁶ .	L5
Mbirryma e kompresorit INV.	L8
Anomali në fillimin e kompresorit INV.	L9
Gabim transmetimi midis inverterit dhe PCB-së së kontrollit.	LC
Mosbalancimi i tensionit të furnizimit me energji elektrike.	P1
Anomali të temperaturës së reaktorit.	P3
Anomali e temperaturës së skajit të rrezatimit të inverterit.	P4
Vendosja në terren pas zëvendësimit të anomalisë kryesore të PCB-së së njësisë së jashtme ose kombinimit të anomalive të PCB-së.	PJ

⁶ INV - Inverteri

Tabela e alarmeve të Sistemit (mes njësive të jashtme/brendshme të lidhura)

Emërtimi i keqfunksionimit (anomalisë) me alarm	Alarmi
<i>Mungesa e ftohësit.</i>	<i>U0</i>
<i>Faza e kundërt, faza e hapur.</i>	<i>U1</i>
<i>Furnizimi me energji i pamjaftueshëm ose anomali e menjëhershme.</i>	<i>U2</i>
<i>Operacioni i kontrollit nuk është ekzekutuar.</i>	<i>U3</i>
<i>Gabim transmetimi midis njësive të brendshme dhe njësive të jashtme.</i>	<i>U4</i>
<i>Gabim transmetimi midis telekomandës dhe njësisë së brendshme.</i>	<i>U5</i>
<i>Gabim transmetimi midis njësive të jashtme.</i>	<i>U7</i>
<i>Gabim transmetimi midis telekomandës kryesore dhe nën telekomandë.</i>	<i>U8</i>
<i>Gabim transmetimi midis njësive të brendshme dhe të jashtme në të njëjtin sistem.</i>	<i>U9</i>
<i>Kombinim jo i duhur i njësive të brendshme dhe të jashtme, njësive të brendshme dhe telekomandës.</i>	<i>UA</i>
<i>Adresoni dyfishimin e pajisjeve të kontrollit të centralizuar.</i>	<i>UC</i>
<i>Gabim transmetimi midis pajisjeve të kontrollit të centralizuar dhe njësisë së brendshme.</i>	<i>UE</i>
<i>Sistemi nuk është vendosur ende.</i>	<i>UF</i>
<i>Anomalitë e sistemit, adresa e sistemit të ftohësit e papërcaktuar.</i>	<i>UH</i>

6.4 Protokollat e mirëmbajtjes

Protokollet e mirëmbajtjes janë përshkruar më poshtë sipas sistemeve të ndara në:

4. Njësitë e brendshme.
5. Njësitë e jashtme.
6. Rikuperatorët e nxehtësisë.

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.3.5. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm

fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit. 41 4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. 5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi. c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës. ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. 7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur. III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor 26 përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme

III.3.6 Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt - ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme, ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë, për të fituar kontratën publike në gjatë 3 (tre) viteve të fundit , nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39% e vlerës së

fondit limit Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, bazuar edhe në konceptin e përgjithshëm të prokurimeve, “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Kontratat e ngjashme, që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jetë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 20% (elementi vlerë) dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshme eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Për përmbushje të kriterit të mësipërm, nga operatori ekonomik “Altec” SHPK, janë paraqitur kontrata furnizimi me mall si më poshtë:

-Vërtetim nr.2110/1 prot., datë 28.02.2021 “Vërtetim realizim kontrate”, lëshuar nga “Universiteti Tiranës” për Kontrata nr.3426/12., datë 26.02.2021, lidhur mes autoritetit kontraktor Uiversiteti Tiranës dhe operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK, me objekt “F/V Sistemi ngrohje ftohje VRF dhe kaldaja” dhe vlerë X lekë me TVSh, e cila është realizuar me sukses. (Pa TVSh X leke)

- Vërtetim realizimi nr.3560/4 prot., datë 23.12.2022, lëshuar nga “Universiteti Tiranës” për operatorin ekonomik “ALTEC” SHPK, për kontratën nr.4127/6 , datë 28.12.2021, me objekt “Mirëmbajtje pajisje teknike per UT (kondicioner, sistemet e ngrohjes, gjenerator,etj) ” si dh realizimit te shërbimit me Nr 4127/13 datë 08.03.2022 me vlerë X me tvsh Kontratës së shërbimit me Nr. 3093/2 datë 15.11.2022 me vlere X leke me tvsh ku totali X leke me TVSH , e cila është realizuar me sukses.(Totali pa TVSH X leke)

Nga verifikimi i furnizimeve të realizuara dhe dokumentacioni shoqërues i tyre, i paraqitur si dëshmi për eksperiencat e mëparshme të ngjashme, konstatohet se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK ka kryer furnizime të ngjashme me zërat në preventivin e hartuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi.

Në lidhje me elementin kohë, Vërtetim nr. 2110/1 prot., datë 28.02.2021 “Vërtetim realizim kontrate”, lëshuar nga “Universiteti Tiranës” për Kontrata nr. 3426/12., datë 26.02.2021, lidhur mes autoritetit kontraktor Uiversiteti Tiranës dhe operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK, me objekt “F/V Sistemi ngrohje ftohje VRF dhe kaldaja” dhe vlerë X lekë me TVSh, e cila është realizuar me sukses. (Pa TVSh X lekë)

- Vërtetim realizimi nr.3560/4 prot., datë23.12.2022, lëshuar nga “Universiteti Tiranës” për operatorin ekonomik “ALTEC” SHPK, për kontratën nr.4127/6 , datë 28.12.2021, me objekt “Mirëmbajtje pajisje teknike për UT (kondicioner, sistemet e ngrohjes, gjenerator,etj)” si dhe realizimit të shërbimit me Nr. 4127/13, datë 08.03.2022, me vlerëX lekw , me TVSH Kontratës së shërbimit me Nr. 3093/2, datë 15.11.2022, me vlere X leke me TVSH, ku totali X lekë me TVSH, e cila është realizuar me sukses. (Totali pa TVSH X) leke janë brenda afatit kohor 3 vjeçar, nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës së procedurës objekt – ankimi, e cila është publikuar më datë **29.12.2023** në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Në lidhje me elementin vlerë, për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 39% të fondit limit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlerat e realizuar me autoritetin kontraktor UT është X lekë pa TVSH, duke e tejkaluar vlerën e kërkuar sipas kriterit të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Në lidhje me elementin natyrë e ngjashme, dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi, për të vërtetuar eksperiencën e mëparshme të ngjashme, është në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi kontratat e mësipërme janë kontrata shërbimi dhe janë kontrata te ngjashme, pasi kemi të bëjmë me “Sisteme të kondicionimit”, në përputhje me kriterin e parashikuar në dokumentet e tenderit dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, sipas përmbajtjes së nenit 41 " *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* ", në pikën 3, ku ndër të tjera parashikohet: "4. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të*

lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve. 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara” Nga ana e ankimesit janë dorëzuar, vërtetim realizim kontrate me një ent publik, duke shënuar, kohën, vlerën dhe realizimin me sukses të kësaj kontrate. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “ALTEC” SHPK vërteton, se ka kryer furnizime të ngjashme me zërat e parashikuar për kontratën objekt - shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK nuk qëndron.

III.4 Lidhur me kërkesën e BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK ku në ankesë parashtron se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK *“Referuar seksionit 2.1 kapaciteti profesional te operateve ekonomik, e cila i perket punimeve te kondicionimit, sipas kesaj pike drejtuesi teknik duhet te jete Inxhinier Mekanik, gje e cila nuk eshte parashikuar ne kerkesat e tenderit. Sipas kesaj pike nuk mund te kemi nje drejtues teknik te profilit Elektrik apo Hidroteknik”.*

III.4.1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 9 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

II. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

B. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
---------------------	-------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

16. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- e) çmimet;
- f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

17. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave

brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimiti profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe gar masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për gru rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspekti Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje li operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet	Po [] Jo []

nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
--	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.4.2 Në shtojcën nr. 8/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në pikën 2.3.2 tek “Kapaciteti Teknik” në dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë: Operatori/ët ekonomikë pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt - prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar, si me poshtë:

Nr.	Stafi	Nr.
1	Drejtues teknik - Inxhinier Hidroteknik/Elektrik	1 (nje)
2	Punonjes / Specialiste per sistem ngrohje ftohje/kondicioner	3 (tre)
3	Punonjës elektrikist	1 (një)
4	Punonjës Hidraulik	1 (një)
	Total	6 (gjashte)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Për drejtuesin teknik te paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Hidroteknik/Elektrik.
- Kontrate pune perkatese.
- Libreze pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencen perkatese.
- Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.

b) Për punonjësit Specialist per sistem ngrohje ftohje/kondicioner, te paraqitet:

- Certifikatë kualifikimi, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontrate pune perkatese.
- Libreze pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencen perkatese.

c) Për punonjësit Specialist Elektricist, te paraqitet:

- Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontrate pune perkatese.
- Libreze pune, ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencen perkatese.

d) Për punonjësit Specialist Hidraulik, te paraqitet:

- Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.
- Kontrate pune perkatese.
- Libreze pune, ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencen perkatese.

Operatori ekonomik te paraqese deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve te punes

Shenim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacionin e kerkuar te cdo punonjesi prane AK.

Shënim:

Me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes, për t'i dhënë mundësi çdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën perkatese të prokurimit, punonjësit e mesipër jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do t'i paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

III.4.3 Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e dorëzuar në Autoritet Kontraktor nga operatori ekonomik "ALTEC" SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

Shtojcën 9 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", sipas të cilës shoqëria "ALTEC" SHPK deklaron Z.A.H, me profesion Inxhinier elektrike, dhe Z.E.Xh në rolin e Inxhinier Hidroteknik.

-Licence me NZ.5214/11 ku me Profil drejtues teknik personi me initiale A.H

- Kontrate Individuale pune Nr. 26444 Rep ; Kol 450 lidhur me shoqërisë "ALTEC" SHPK me punëmarësin A.H, ku puna që do të kryhet është Drejtues Teknik në profesion Inxhinier Elektrik dhe kjo kontratë është me afat kohor 5 vjeçar me të drejte përsëritjeje. Lidhur kjo kontratë më datë 25.04.2019.

- Vërtetim Nr. T09779313 lëshuar më datë 17.01.2024, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Fier me objekt (Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Individin- E-Sig03/a) për Z A.H

- Diplomë. – Nr. 3572, titulli i dhënë Inxhinier Elektrik Z A.H, lëshuar me datë 15.5.1977.

- Librezë Pune me datë fillimi hyrje në punë me datë 04.05.2019- Inxhinier Elektrik - CV.

-Deklaratë në formë tabele, ku personi me initiale A.A në cilësinë e administratorit të operatorit ekonomik "ALTEC" SHPK, ka plotësuar tabelen me Emer Mbiemer të punonjësveve, Profesionin; dhe datën e fillimit të mardhenieve të punës. Datë dorëzimi të deklaratës 15.01.2024, me nënshkrimin e ofertuesit A.A dhe vulën e kompanisë.

III.4.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm

ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.4.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.4.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për mospërbushjen e kriterit nga ana e operatorit ekonomik “ATEC” SHPK, rezulton, se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar 2.3.2 tek “Kapaciteti Teknik” se *Operatori/et ekonomik pjesëmarres për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht të punësuar, si me poshte:*

Nr.	Stafi	Nr.
1	Drejtues teknik - Inxhinier Hidroteknik/Elektrik	1 (nje)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

e) Për drejtuesin teknik të paraqitet:

- *Diplomë me profesion Inxhinier Hidroteknik/Elektrik.*
- *Kontrate pune perkatese.*
- *Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatese.*
- *Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të leshuar nga e - albania.*

Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK ka deklaruar në ofertën e tij, nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, se ka të punësuar Z. Z.A.H, me profesion Inxhinier elektrike, dhe Z.E.Xh në rolin e Inxhinier Hidroteknik, referuar dokumentacionit punonjësi me iniciale A.H me detyrë Drejtues Teknikë. Për sa më sipër cituar, duke qenë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt-shqyrtimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “ALTEC” SHPK provon, se ka të punësuar znj A.H si Drejtuese Teknikë, kjo nëpërmjet Kontratës Individuale të punës dhe Licenes Nr. NZ.5214/11, ku me Profil drejtues teknik është personi me iniciale A.H.

III.4.7. Referuar sa më sipër, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të vërtetojë se disponon punonjësin Drejtues Teknik, ka kërkuar dokumentacionin - Diplomë me profesion Inxhinier Hidroteknik/Elektrik.-Kontrate pune perkatese- Librezë pune ose cdo dokumentacion tjetër që verteton eksperiencën perkatese.-Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune në këtë profesion. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të leshuar nga e - albania.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK për përmbushjen e kriterit lidhur me disponimin e Drejtuesit Teknik për Shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrisë, KPP vëren se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dhe në formë shkresore, dokumentacionin provues lidhur me Drejtuesin Teknik. KPP gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin lidhur me Drejtuesin Teknik të kërkuar në përputhje me kërkesat në kriterin e vecantë të kualifikimit. Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK nuk qëndron .

III.5 Lidhur me kërkesën e BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK në të cilën parashtron se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK nuk përmbush kërkesën për kualifikim lidhur me “ --Te verifikohet nëse ka pasur deklarate për mbështetjen në kapacitetet e të tjerëve dhe si provohet.

III.5.1 . Në shtojcën 9 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

III. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

C. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

• *Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik*

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

<i>Deklarata</i>
<p><i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektivin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p><input type="checkbox"/> <i>ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><input type="checkbox"/> <i>kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p><input type="checkbox"/> <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

<p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

19. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
20. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
21. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

22. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
23. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
- e) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - f) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
24. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
25. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- i) çmimet;
 - j) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - k) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - l) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
26. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
27. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimiti profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.5.2 Operatori ekonomik “ALTEC” SHPK ka ngarkuar ne SPE, dhe dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor Formualrin e Vetedeklarimit si me poshtë vijon:



Tel: +355 44803050
 Fax: +355 44803051
 E-mail: info@altec-al.com
 Web: www.altec-al.com

Shtojca 9

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari **Arben Allaj** në cilësinë e **Administrator** të operatorit ekonomik **Altec shpk** deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	ALTEC shpk
Numri NIPT/et:	K57923807W
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Rruga e "Durrësit", pranë gjimnazit "Qemal Stafa", pallati 240/1, nr 6 Kodi postar 1057
Përfaqësuesi (emri):	Arben Allaj
Telefoni:	+355692063153
E-mail:	info@altec-al.com

Data e dorëzimit të deklaratës
Emri, Mbiemri

15/01/2024
Arben Allaj

Firma, Vula



B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT-i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar
NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et
NUK KA	NUK KA	NUK KA	NUK KA

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

III.5.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.” I

III.5.5. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: 1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme: a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi; dh) falsifikim; e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur

personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur: a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi; b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit; c) operatori ekonomik nuk ka paguar shumën të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh; ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë; b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji; c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi; ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën; d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja; e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji. ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit; f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin. g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga

e drejta për të përfitur fondet publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim. Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një veprë penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera. Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.5.6 . Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.5.7. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.5.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për

ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.5.10. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës; - t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme. - t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së. - Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.5.11. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kriteret e vendosura me anë të dokumentacionit të dorëzuar në përputhje dhe me përcaktimet ligjore. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që puna/shërbimi/malli i ofruar është në përputhje me kërkesat e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i tyre duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.5.12 KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.5.13.. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, që të vërtetohet nëse operatori ekonomik “ALTEC” SHPK mbështetet në kapacitet në një subjekti tjetër, nga shqyrtimi, i dokumentacionit të dorëzuar në SPE dhe dorazi nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK konstatohet, se ky i fundit, ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Në Nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht, se për pikën 1 të nenit 76 të Ligjit “Për Prokurimin Publik”, nga ana e operatorit ekonomik duhet të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në rregullat e prokurimit publik. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se “në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti

mbështetës”. Në procedurën objekt-shqyrtimi, operatori ekonomik ankimues “ALTEC” SHPK, ka deklaruar, se nuk do të mbështetet ne subjekt tjetër, kjo e fundit referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Pra mbështetja në kapacitet sipas Legjislacionit të Prokurimit Publik është më vetëdeklarim nga ana e operatorit ekonomik pjesëmarrës në këtë procedure prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimet e BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK ankimues nuk qëndrojnë.

III.6 Lidhur me kërkesën e BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK ku në ankesë parashtron, se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK nuk përmbush - *Te verifikohet a i ka deklaruar te gjitha detyrimet e OSHE per te gjitha vendet qe ushtron aktivitetin*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 9 “*Formulari i Vetëdeklarimit*”, përcaktohet kërkesa si më poshtë:

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*_____

III.6.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike ashtu dhe nga dokumentacioni i operatorit ekonomik “ALTEC” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

Vërtetim debie nr. OSHEE-2024-5707941-1A prot., datë 09.01.2024 , ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z.A.A , vërtetohet se kërkuesi ALTECSHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratën (me kod) FXXXXXXXX, përdorues i të cilit është AALTEC shpk rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri me datën 09.01.2024 pa përfshirë faturenkoherente të muajt dhejtor 2023.

III.6.3 Në shtojcën 8, të “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1/a, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

12. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

III.6.4 . Në shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

IV. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

D. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: <i>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)</i>	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatorin ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatorin ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p>

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

28. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

29. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

30. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

31. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

32. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

g) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;

h) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

33. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
□
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). □

34. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6.a) dhe 6.b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- m) çmimet;
n) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
o) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
p) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

35. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

36. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe

territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimin dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në	Po [] Jo []

përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
---	--

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> <u>Profili i punonjësve</u> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

- III.6.5 . Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur;

III.6.6 . Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.*

III.6.7 Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

III.6.8 Nisur nga pretendimet e ankimuesit, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili nga verifikimi konstatohet, se është plotësuar sipas Shtojcës 9 të dokumenteve të tenderit.

III.6.9 Nisur nga pretendimet e BOE ekonomik ankimues, dokumentet e tenderit, si dhe informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstaton se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, si operator ekonomik i kualifikuar i pari në këtë procedurë prokurimi, në zbatim të nenit 26 pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në Pjesën II, A, parashikohet “*Deklaratë Për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme*”. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, dhe nga dokumentacioni i dorëzuar në autoritet, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Për këtë arsye, duke qenë se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK është kualifikuar i pari në procedurën e prokurimit, KPP në kuadër të shqyrtimit të ankesës së BOE “Ecs Eco Climate

Solution SHA & Edemeli SHPK, për skuafikimin e operatorit ekonomik "ALTEC" SHPK, në datën 28.03.2024 në formë shkresore, Komisioni i Prokurimit Publik, i dërgon shkresë Autoritetit Kontraktor Agjencisë Shtetërore Të Prokurimeve në mbështetje të nenit 82, pika 5, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, të dorëzojë pranë KPP-së dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik "ALTEC" SHPK, i renditur i pari.

Nëpërmjet shkresës nr. prot 364/7, protokolluar në KPP me nr.613/6, datë 05.04.2024, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik "ALTEC" SHPK, gjithsej 495 faqe.

Referuar Pretendimeve të BOE ankimes, se operatori ekonomik "ALTEC" SHPK nuk permbush kriterin lidhur me deklaratimet dhe vertetimet e OSHEE, Komisioni i Prokurimit Publik në 22.05.2024, dërgon shkresën Nr. 613/9 prot., me lëndë "Rikërkesë për informacion" FSHU me përmbajtje "Komisioni Prokurimit Publik ka dërguar shkresën me lëndë "Kërkesë për informacion" me nr. 613/8 datë 09.04.2024, me përmbajtje :[...] Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:

1. Kontratat e energjisë elektrike së bashku me adresat në të cilat është titullar ose përdorues subjekti tregtar "ALTEC" SHPK, të cilat janë aktive në datën 15.01.2024.

2. A rezulton të jetë subjekti tregtar "ALTEC" SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresat e Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar Historik bashkëlidhur?

3. Nëse është përdorues në adresat e mësipërme (në ekstraktin e regjistrimit tregtar historik), a ka patur detyrimin që subjekti tregtar "ALTEC" SHPK ta deklarojë këtë fakt pranë furnizuesit me energji elektrike "Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU" ?[...].

Pranë Komisionit Prokurimit Publik nuk kemi asnjë përgjigje nga ana juaj mbi shkresën e dërguar nga ana jonë. Ju lutemi, sa më sipër, për një shqyrtim sa më të drejtë të çështjes, të dërgoni pranë Komisionit Prokurimit Publik informacionin e kërkuar ?[...]

III.6.10 Në datën 28.05.2024, Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A, ka kthyer përgjigje me shkresën me Nr.2357/2, protokolluar me tonën Nr. 613/10 prot., datë 28.05.2024, me lëndë "Kthim - Përgjigje" ku citohet se " Në përgjigje të shkresës Nr. 613/9 Prot, date 22.05.2024, të regjistruar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A, me Nr.2357/1 Prot, date 23.05.2024 me ane të se cilës kerkoni paraqitjen e informacionit, sqarojme si vijon: 1) Subjekti " ALTEC" SHPK, referuar sistemit tone të faturimit ka

1 (një) kontrate të furnizimit me energji elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal SHA pjesë e Grupit OSHEE Nr. XXXXXXXXXX, në instancën Tirane.

2) Subjekti " ALTEC" SHPK, rezulton si përdorues i 1 (një) kontrate në instancën Fier, me Nr.XXXXXXXX dhe me titullar Z. T.H.A.

Referuar sistemit tone të faturimit, ju veme në dijeni se me adresë e kemi të pamundur të identifikojmë kontratën dhe abonentin. Sistemi mundëson gjurmimin e kontratës vetëm me numër matesi, numer kontrate dhe me gjeneralitete të abonentit (emer, atesi, mbiemer).

. 3) *Bashkëlidhur gieni detajet e kontrates, si dhe giendjen e debise per kontratat e siperpermendura. Me konsiderate,*

III.6.11 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, i dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konstatohet, se operatori ekonomik “ALTEC” SHPK, për të provuar deklaratimet e tij për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, konkretisht pikës dh) dhe e) në dokumentet e tenderit, konstatohet, se ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentin si më poshtë:

- Vërtetim Debie nr. OSHEE-2024-5707941-1A prot., datë 09.01.2024 , ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit Z.A.A, vërtetohet se kërkuesi ALTECSHPK, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën/kontratat (me kod) **XXXXXXXX**, përdorues i të cilës është ALTEC SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 09.01.2024, pa përfshirë faturën koherente të muajt dhjetor 2023.

III.6.12. Në nenin 11 (Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike), paragrafi 11.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: *“11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit.”*

III.6.13 Në nenin 13 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 13.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të ERE “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë”, përcaktohet shprehimisht që: *“13.1 Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike jo më vonë se 30 ditë, nga data e lëshimit të faturës së fundit si dhe kur është rasti kamatëvonesat përkatëse.”*

III.6.14 KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë tij, si dhe duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt - shqyrtimi, lidhur me një nga pretendimet e ngritura nga BOE ankimes, në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua nëpërmjet shkresës Nr 613/9 prot., datë 22.05.2024 FSHU, duke i kërkuar informacion në lidhje me kontratat e energjisë elektrike për subjektin “ALTEC” SHPK, nëse është titullar ose përdorues për adresat e sipërcituara në shkresë. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SHA., këtu e në vijim (FSHU), në datën 28.05.2024, ka kthyer përgjigje me shkresën me Nr.2357/2 protokolluar me tonën Nr 613/10 prot., datë 28.05.2024., me objekt: *“Kthim - përgjigje”*, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilën jepet informacioni si më poshtë në mënyrë të përmbledhur: *Në përgjigje të shkresës Nr. 613/9 Prot, date 22.05.2024, të regjistruar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal Sh.A, me Nr.2357/1 Prot, date 23.05.2024, me ane të cilës*

kerkoni paraqitjen e informacionit, sqarojme si vijon: 1) Subjekti "ALTEC" SHPK, referuar sistemit tone te faturimit ka

1 (nje) kontrate te furnizimit me energji elektrike me Furnizuesin e Sherbimit Universal sha. pjese e Grupit OSHEE Nr TXXXXXXXXX,, ne instancen Tirane.

2) Subjekti "ALTEC" SHPK, rezulton si perdorues i 1 (nje) kontrate ne instancen Fier, me Nr.FXXXXXXXX dhe me titullar z T.H.A.

Referuar sistemit tone te faturimit, ju veme ne dijeni, se me adrese e kemi te pamundur te identifikojme kontraten dhe abonentin. Sistemi mundeson gjurmimin e kontrates vetem me numër matesi, numer kontrate dhe me gjeneralitete te abonentit (emer, atesi, mbiemer).

3) Bashkëlidhur gjeni detajet e kontrates, si dhe gjendjen e debise per kontratat e siperpermendura. Me konsiderate,

III.6.15 Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik "ALTEC" SHPK si i kualifikuar i pari, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike ashtu dhe dorazi, një vërtetim me nr. OSHEE-2024-5707941-IA prot, datë 09.01.2024, nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti "ALTEC" SHPK nuk rezulton debitor, deri në datën 019.01.2024, përfshirë edhe vlerën e faturës koherente të muajit Dhjetor 2023, për kontratën me kod FXXXXXXXXXX, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit dt. 15-01-2024 dhe Vendimit të ERE nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë". Referuar Kthim - Përgjigjes së FSHU datë 28.05.2024, me nr. 2357/2 prot., rezulton se subjekti "ALTEC" SHPK ndër të tjera, ushtron aktivitet dhe në Instancën Fier, me një kontratë furnizimi me NR. TXXXXXXXX, në emer të subjektit "ALTEC" SHPK.

KPP gjykon, se FSHU SHA, është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Furnizuesin e Sherbimit Universal Sh.A., operatorit ekonomik "ALTEC SHPK", rezulton se shoqëria disponon dy kontrata të energjisë elektrike, me adresa një në Fier dhe një në Tiranë .

Referuar sistemit prokurimeve elektronike, dhe dokumentacionit të dorëzuar në autoritetet rezulton, se subjekti "ALTEC" ka paraqitur vërtetim debie vetëm për njërën nga adresat e ushtrimit të aktivitetit nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA, ku rezulton me kontratë furnizimi në instancen Fier, ndërkohë për Instancen Tiranë, nga verifikimet në SPE ashtu dhe dokumentacioni i dorëzuar dorazi, nuk rezulton të ketë dorëzuar vërtetim debie për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për kontratën e furnizimit me Nr. TR. TXXXXXXXX. Në rastin konkret, operatori ekonomik "ALTEC" SHPK për adresën Tiranë, nuk ka arritur të provojë së ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike, kjo referuar shkresës së FSHU, bashkëlidhur të dhenat e konsumatorit në emër të "Emri A.A në "ALTEC SHPK +NIPT K62315010T në K57923807W PR/12947/18 DT 08.09.2015 A QENDRO". Sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik "ALTEC" SHPK, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike, për kontratën e furnizimit me Nr. XXXXXXXX në instancën Tiranë, duke mos përmbushur në këtë mënyre, kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në dokumentet standarde të tenderit.

Sa më sipër, pretendimi BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK ankimues, qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-92444-12-28-2023, me objekt “Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të kondicionimit të ndërtesës së Kryeministrit”, me fond limit 35,977,266 pa TVSH, zhvilluar më datë 15.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik”ALTEC” SHPK, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik
4. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Ecs Eco Climate Solution SHA & Edemeli SHPK”.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

